



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

**Dokument parlamentar**

**PROCESVERBAL**

Datë 07.07.2014, ora 09:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit
2. Miratimi i kalendarit të komisionit për periudhën 4 – 25 korrik
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësohet nga Ministria e Financave dhe Unicredit Bank Austria AG, lidhur me financimin e projektit “Modernizimi i sistemit arsimor në Shqipëri nëpërmjet E-edukimit”
4. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” të ndryshuar”.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Mark Frroku, Petrit Vasili, Spartak Braho, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Silva Caka, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Blendi Klosi, Vexhi Muçmataj, Armando Prenga, Kastriot Islami dhe Xhemal Qefalia.

**Mungojnë:**

. Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Tom Doshi, Arben Ristani, Edi Paloka, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Keltis Kruja, Fatmir Mediu, Mhill Fufi dhe Gjovalin Bzheta.

**Të ftuar:**

Erjon Luçi – zëvendësministër i Financave

Erzen Tola- drejtor juridik në Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit

Milbana Treska – drejtore e Drejtorisë së Borxhit në Ministrinë e Financave

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** - Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Pikë e parë e rendit të ditës është kalendari i komisionit.

Ka ndonjë sugjerim apo mendim nga kolegët për kalendarin e komisionit?

Nuk ka.

Dakord? Vërejtje? Sugjerime? Nuk ka. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Dakord.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësohet nga Ministria e Financave dhe Unicredit Bank Austria AG, lidhur me financimin e projektit “Modernizimi i sistemit arsimor në Shqipëri nëpërmjet E-edukimit”.

I pranishëm është zoti Erjon Luçi, zëvendësministër i Financave.

Faleminderit, zoti Luci, se mos gaboj, jeni për herë të parë në këtë komision!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kjo është hera e dytë. Dakord. Faleminderit që rierdhët në komision!

Zoti Erzen Tola, drejtor juridik në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dhe...

**Ornela Koleka** - Ornela Koleka, nga Ministria e Arsimit.

**Fatmir Xhafaj** – Ok, kënaqësi!

Atëherë, zoti Luçi, ju do të bëni një paraqitje të përmbledhur? Ju lutem, shumë shkurt!

**Erjon Luçi** – Kjo është pjesë e një marrëveshjeje që ju keni kaluar edhe më më përpara, është marrëveshja e nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Austrisë për shumën 40 milionë dhe ky është një ndër komponentët e të njëjtit program, vetëm se në këtë rast kemi të bëjmë më shkollën elektronike. Çfarë do të realizojë ky si projekt, është dhënia e mundësisë së krijimit të klasave virtuale, domethënë, në pamundësi edhe të të qenit të pedagogëve për lëndë të caktuara të mund të ketë edhe klasa virtuale *on line*, që është një nga komponentët më kryesore të projektit të parë.

I dyti është pikërisht për krijimin e kurrikulave nga vetë mësuesit të këtyre klasave virtuale, që mund të jenë të aksesueshme më gjerë sesa mund të mësojnë mësuesit vetëm me klasat fizike,

Dhe e fundit, dy kurrikula, e anglishtes dhe e IT-së, do jenë kurrikula që do të jenë të mundësueshme që në fillim të projektit. Domethënë, shkollat që kanë akses në internet, do kenë mundësi, për shembull, të krijojnë këto klasa virtuale menjëherë në fillim të projektit.

Në aspektin e termave, këto janë terma jashtëzakonisht të buta, kredia është rreth 3.5 milionë, me interes zero, por me tarifat e angazhimit 0505, domethënë interesi shkon aty te 1-përqindëshi, por është jashtëzakonisht i ulët.

Pak a shumë kjo është me pak fjalë pjesë e projektit.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ka pyetje? Besoj se është e qartë.

Nuk ka pyetje.

Ka diskutime? Nuk ka diskutime.

Në fund të fundit, me këto kushte që tha zëvendësministri, mirë bëhet edhe për një gjë që ka interes për shoqërinë, janë dy kushte të mjaftueshme.

Zonja relatore, urdhëroni!

**Silva Caka** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky projektligj vjen me nismën e Këshillit të Ministrave dhe hartuar me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Do të doja të cilësoja pak qëllimin dhe përmbajtjen e projektligjit për të qenë sa më të qartë.

Sipas relacionit shoqërues, qëllimi i projektligjit është modernizimi i sistemit arsimor në Shqipëri nëpërmjet edukimit elektronik është sigurimi i një platforme për të gjithë nxënësit e sistemit publik të arsimit parauniversitar në Shqipëri. Ky projekt do të mundësojë për secilin nxënës aksesin në një paketë kursesh dhe eksperimentesh të krijuara nga një panel mësuesish të zgjedhur sipas kompetencave lëndore, si dhe do të shërbejë si një platformë shkëmbimi dijeshe dhe përvojash mësimore.

Projekti merr në konsideratë praktikatat më të mira të vendeve perëndimore duke mbajtur në vëmendje specifikat e realitetit tonë. Gjithashtu, autoritetet kompetente për zbatimin e marrëveshjes janë Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe e Sportit.

Në aspektin procedural projektligji ka respektuar të gjitha kërkesat sipas Rregullores së Kuvendit dhe në aspektin ligjor është në përputhje me Kushtetutën, prandaj sugjeroj miratimin dhe kalimin në seancë plenare.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zonja Caka!

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Miratohet neni 1? Dakord.

Neni 2? Dakord.

Në tërësi ? Dakord.

Kundër? Abstenim? Nuk ka

Miratohet.

Faleminderit, zoti zëvendësministër! Faleminderit të gjithëve! Punë të mbarë!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 07.07.2014, ora 09:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” të ndryshuar”.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Mark Frroku, Petrit Vasili, Spartak Braho, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Silva Caka, Nard Ndoka, Tahir Muhedini, Blendi Klosi, Vexhi Muçmataj, Armando Prenga, Kastriot Islami dhe Xhemal Qefalia.

**Mungojnë:**

. Oerd Bylykbashi, Dashamir Peza, Tom Doshi, Arben Ristani, Edi Paloka, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Keltis Kruja, Fatmir Mediu, Mhill Fufi dhe Gjovalin Bzheta.

**Të ftuar:**

Alfred Çareri – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetsisë

**Fatmir Xhafaj** - Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636 datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”” Besoj do të zërë vend zoti Alfred Çareri sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë. Ju do ta përballoni vetë atë, zoti Çareri. Me sa shoh, jeni në gjendje ta përballoni. Ju lutem, një paraqitje të shkurtër të iniciativës.

**Alfred Çareri** – Ligji “Për mbrojtjen e produkteve nga duhani”, i cili është miratuar në vitin 2006 erdhi si një domosdoshmëri dhe si një detyrim që kishim ndaj Konventës së miratuar në vitin 2003, të OBSH-së, e cila ishte si një instrument legal, i rëndësishëm për kontrollin e produkteve të duhanit, në rang botëror dhe e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2005. Kështu që në vitin 2006 u miratua ligji kundër duhanit dhe produkteve të tij. Por gjatë gjithë këtyre viteve u pa se ky ligj nuk gjeti një zbatim shumë të madh në Shqipëri. Në këto kushte u pa e domosdoshme nga ana jonë për t’i bërë disa ndryshime këtij ligji, duke e forcuar edhe më tepër, për të arritur në qëllimin tonë, parandalimin e pirjes së produkteve të duhanit në ambientet publike dhe për uljen e numrit të personave që përdorin duhan. Nga një studim i ISHP-së rezulton se në Shqipëri vdesin rreth 3300 duhanpirës në vit. Rreth 40% e popullsisë në Shqipëri i përdorin produktet e duhanit, ndër të cilët 60% janë meshkuj dhe 18 % femra. Kjo është një e dhënë që vjen nga ISHP-ja. Kjo ishte një përmbledhje në tërësi. Më në detaje kemi renditur si një detyrim që TVSH-ja të transmetojë...

**Fatmir Xhafaj** – Nuk ka rëndësi, këto që janë këtu janë të qarta. Faleminderit! Zonja relatore, vlerësimi juaj për projektligjin.

**Silva Caka** – Faleminderit! Projektligji është i bazuar në nenin 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës. Ndërkohë që nga analiza e nenit 81, pika 2 e Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të projektligjit, rezulton se fusha, që rregullon ky projektligj, nuk përfshihet në asnjë prej çështjeve që trajton ajo dispozitë kushtetuese dhe miratimi i projektligjit i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës. Hartimi i projektligjit ka si qëllim ndërgjegjësimin e publikut për dëmet nga duhani dhe garantimin e një informimi efektiv dhe të vazhdueshëm të përdoruesve të produkteve të duhanit për këto dëme. Nevoja për rishikim është rrjedhojë e situatës dhe zbatimit të dobët të tij nga subjektet private dhe institucionet përgjegjëse, që kanë detyrimin ligjor të ndjekin zbatueshmërinë e ligjit. Njëkohësisht, projektligji përbëhet nga 5 nene dhe ndryshimet që propozohen të sjellin dhe risitë janë pikërisht:

Detajimi dhe kategorizimi i mjediseve publike të mbyllura, në të cilat do të ndalohet duhan-pirja.

Përcaktimin e institucioneve përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e ligjit. Nga projektligji rezulton të jetë shtuar gama e institucioneve që ndjekin zbatueshmërinë e tij.

Përfshirja e trupave të tjera inspektuese në kontrollin e zbatimit të ligjit në lidhje me ndalimin e duhanpirjes në mjedise publike të mbyllura.

Parashikimi i tri niveleve të gjobave për kundërvajtje administrative të duhanpirjes në mjedise publike, ku konkretisht për duhanpirësin 500 lekë dhe administratorin e përgjithshëm përgjegjës 50 mijë lekë dhe për pronarin 30 mijë lekë.

Detyrimi i RTSH-së për të transmetuar programe të ndërgjegjësimit për efektet e dëmshme të duhanit për shëndetin e çdo individi dhe mbrojtjen e publikut nga efektet e duhanpirjes.

Çështjet që ka ngritur ky komision për diskutim dhe propozime janë konkretisht për sa i takon teknikës legislative dhe propozoj të bëhet riformulimi i neneve të projektligjit si më poshtë:

Neni 4 duhet të riformulohet, pasi ka pasaktësi dhe referenca të gabuara në nenet e tjera të projektligjit. Konkretisht shkronja “gj” duhet të rishikohet, pasi inspektoratet dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, që përmenden, nuk korrespondojnë me përcaktimet e bëra në shkronjën “e” të nenit 15, në mjediset e përbashkëta dhe banesave me bashkëpronësi të detyrueshme. Ndërsa në shkronjat “h”, “i” dhe “j” të këtij neni referimi bëhet në disa shkronja të nenit 15, që nuk ekzistojnë konkretisht.

Njëkohësisht, një sugjerim i komisionit është që neni 6 i projektligjit duhet të numërohet në nenin 5, sipas renditjeve të neneve në projektligj.

Si përfundim, në aspektin ligjor ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi. Në aspektin procedural është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Pa gjoba, ky vend nuk po mbahet, jo më...

Dakord.

Ka pyetje?

Zoti Klosi, urdhëroni!

**Blendi Klosi** – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Ky nuk është një ligj i ri, ka vite që diskutohet në Shqipëri, që është ndalimi i përdorimit të duhanit në ambientet publike dhe realisht e mbështes me shumë pasion.

Pyetja ime është: I nderuar përfaqësues i ministrisë niveli i ulët i gjobave, që në fakt, nuk ka qenë i ulët deri tani, ka qenë arsyeja dhe shkaku pse në ambientet publike vazhdon të pihet duhan, apo moskonsistenca e kërkesës së zbatimit të ligjit? Unë nuk e di se në cilin studim ju keni gjetur nevojën e rritjes së gjobave për subjektet publike.

Mendoj se më shumë se rritja e gjobave, arsyeja ka qenë mosfunksionimi i inspektorateve përkatëse, që duhet të ndalonin përdorimin e duhanit në ambientet publike.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Çareri!

**Alfred Çareri** - Ndryshimet u panë në mënyrë komplekse, në mënyrë që të mos ishte vetëm një inspektorat i vetëm, por të funksionin të gjitha inspektoratet për të kontrolluar zbatueshmërinë e ligjit, njëkohësisht, edhe rritja e nivelit të gjobës. Pra, këto të dyja ishin elementet, të cilat u panë nga ana jonë si një fakt për të ulur nivelin e duhanpirjes në Shqipëri.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ka pyetje tjetër?

Zonja Felaj, urdhëroni!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit zoti kryetar!

Unë kam dy pyetje. Shikoj që në nenin e parë të projektit ju keni parashikuar detyrimin e RTSH-së që të transmetojë programe debative çdo muaj me një kohëzgjatje minimale prej 90 minutash. Pse nuk keni parë si më të arsyeshme që të kishin programe edukative, duke filluar nga nivelet më të ulëta të shkollës, pra, që në ciklin 9- vjeçar, ku nxënësit të edukohen për rreziqet e duhanpirjes?

E dyta, në nenin 19 të projektit ju keni përcaktuar institucione përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të këtij ligji.

A ju duket e arsyeshme që në vend të një inspektorati të vetëm, që të ndjekë ecuritë e kësaj problematike, të kemi edhe shumë organe të tjera, që të ndjekin ecurinë e kësaj problematike, në një kohë që ato nuk e kanë funksion parësor? Sa të sigurt jeni që do ta bëni,

sepse organet tatimore nuk kanë funksion parësor të ndjekin duhanpirjet, sikurse edhe policia bashkiake dhe ajo e komunave, po ashtu nuk e ka për funksion parësor. Pra, ku doni të arrini?

Kam edhe një pyetje tjetër. Ju keni vënë Policinë Bashkiake dhe Komunare, por a keni pasur parasysh që në Shqipëri po ndodh reforma territoriale dhe këto polici nuk do të ekzistojnë më si të tilla, ose të paktën me këtë emërtim?

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Atëherë, përgjigjuni për të dyja pyetjet!

**Alfred Çareri** - Siç e thashë edhe më lart, një institucion i vetëm nuk arriti deri në atë masë sa të kontrollonte zbatueshmërinë e ligjit, siç ishte në rastin konkret, pra që nga viti 2006 e deri më sot, një inspektorat i vetëm nuk arriti të kontrollonte zbatueshmërinë e ligjit, pra jemi koshientë për gjithë këtë moment. Kështu që ne menduam se të gjitha inspektoratet bashkë, në çdo kohë, duke qenë se do të kenë në tagër të tyre edhe kontrollin dhe zbatueshmërinë e këtij ligjit, do të arrijnë të minimizojnë pirjen e duhanit në ambiente publike. Kjo ishte e para.

E dyta, e kemi marrë parasysh edhe elementin e reformës territoriale, por mbetet për t'u riparë.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një pyetje lidhur me tabelën që ju i keni bashkëngjitur relacionit të projektligjit, nga e cila rezulton se ka pasur disa institucione përgjegjëse për zbatimin e ligjit të vitit 2006 dhe shoh që masat e zbatimit janë pothuajse të pazbatuara. Duke ia lënë inspektimin e pirjes së duhanit në mjedise të ndryshme përsëri disa institucioneve, a mendoni se këto masa do të zbatohen? Pyetja e parë.

Pyetja e dytë ka të bëjë me nenin 20. Ju këtu parashikoni gjoba dhe dënime fikse. Nga vështrimi i këtij neni shihet se gjobat disa herë janë shumë më të larta se gjoba si dënim penal. Gjithashtu, ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese që nuk lejon dënimet fikse, pra gjoba 50 milionë, 30 milionë lekë të vjetër, pra mendoj se do të jetë më abuzive nëse lihet fikse dhe është antikushtetuese. Cila është arsyeja që keni arritur në këto lloj dënimesh gjoba fikse?

Pyetja e tretë ka të bëjë pikërisht me nenin 19. Ju ngarkoni institucione të ndryshme me kontrollin e pirjes së duhanit, por a i keni parë ligjet e tjera? A ka ndonjë nen në ligjin e Policisë së Shtetit, për shembull, që Policia e Shtetit të kontrollojë pirjen e duhanit, ose një nen për

Policinë Tatimore, ose për Policinë Bashkiake, sepse thuhet: “Inspektimi i shumë institucioneve të tjera, veprimtaria e të cilave rregullohet me ligjet organike të tyre”?

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Po, zoti sekretar i përgjithshëm.

**Alfred Çareri** – Atëherë, e kemi parë që, pavarësisht, se kanë qenë shumë institucione që e kanë kontrolluar zbatueshmërinë e ligjit, tani mendojmë se me ngritjen e inspektorateve, nisur edhe nga fakti që kemi një inspektorat qendror, i cili do të koordinojë të gjithë veprimtarinë, do të jetë më afër zbatueshmërisë si ligj. E para.

E dyta, ne kemi marrë si referencë ligjin në Kosovë, i cili parashikonte gjopa relativisht të larta për duhanpirjen. Kjo ishte një nga arsytet. Ndërkohë duhet të themi se zbatueshmëria e ligjit në Kosovë është shumë e lartë, prandaj e morëm si referencë atë.

Për sa i përket faktit tjetër, që projektligji i ka kaluar të gjitha hallkat edhe kodifikimin, edhe drejtorinë Juridike në Këshillin e Ministrave, mendoj se është gjë e mirë.

**Fatmir Xhafaj** – Më vjen mirë që për duhanin keni pyetje të gjithë, por dua t’ju kujtoj si kolegë, sepse është e drejta ime t’ju kujtoj, pastaj edhe ju keni të drejtën të bëni pyetje, se ne nuk jemi komision përgjegjës. Komision përgjegjës është Komisioni për Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Ne do t’i sugjerojmë atij komisioni-mbajeni në konsideratë këtë fakt.

Zoti Xhemal!

**Xhemal Qefalia** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë, në fakt, jam i shqetësuar meqë s’e pimë, se më shumë e pësojmë ne që s’e pimë.

Duke iu referuar në tërësi ligjit, është një ligj që, siç e tha edhe deputeti Klosi, vjen si rezultat i moszbatimit sa dhe si duhet i ligjit paraprak. Gjithsesi, unë pyetjet i kam konkrete. Në nenin 15 thuhet rastet që ndalohet dhe një ndër pikat është edhe në mjediset sportive. Pika, në mos gabohem, mjediset sportive, është germa “v”: “ndalohet pirja e duhanit në mjediset kulturore dhe sportive”.

Këtu kemi parasysh se edhe në stadione do të jetë e njëjta gjë? Mos ka nevojë për t’u rregulluar në teknikën legjislative që të thuhet: “Mjediset kulturore sportive të mbyllura”?

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Po, faleminderit!

**Alfred Çareri** – Atëherë, u ra dakord edhe me këshilltarët tuaj të Komisionit të Ligjeve për t’u riparë ky element, dhe i tërë ai nen, për t’u riformuluar pak më mirë dhe do t’ju sjellim draftin përkatës.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull! Faleminderit!

Po. E ngriti relatorja këtë gjë, kështu që besoj se është e qartë. Ka pyetje tjetër?

Zoti Subashi ka një pyetje tjetër.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Vetëm pyetje. Pyetje, ju lutem!

**Armando Subashi** –Pyetja e parë, tek neni 6 i projektligjit.

**Fatmir Xhafaj** – Po kur të vemi nen për nen.

Në parim e ke pyetjen?

**Armando Subashi** – Po, po në parim. Keni parashikuar te pika 2 që i ndani dënimet në kryesore e në plotësuese. Për çfarë efektesh është bërë kjo në ligj?

Tek neni 6, pika 2, thoni: “Masat e konfiskimit dhe asgjësimit janë dënime kryesore, ndërsa masa e gjobës është dënim kryesor” e të tjera e të tjera. Për çfarë qëllimi është bërë kjo ndarje: dënim kryesor dhe dënim plotësues? Pyetja e parë kjo.

Pyetja e dytë: pika 3 e po këtij neni... A po më ndjek?

**Alfred Çareri** – Po.

**Armando Subashi** – Pika 3 e po këtij neni thotë: “Ankimi ndaj vendimeve të trupave inspektuese, të përcaktuara në këtë ligj, bëhet në përputhje me ligjin “Për inspektimin”, ndërsa ankimi ndaj organeve tatimore, doganore, Policisë së Shtetit, policisë bashkiake ose të komunës, bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Edhe unë që jam jurist këtu, në rast se marr një gjobë, duhet të hap një dhjetë ligje që të gjej se ku do të ankimoj. Mendo pastaj një qytetar i thjeshtë apo një subjekt e të tjera e të tjera.

Pyetja është konkrete: a është e mundur që ta specifikojmë saktë këtë gjë, ku kam unë të drejtë të ankohem, nëse marr një sanksion? Besoj se këtu jemi brenda misionit që ka edhe komisioni ynë. Kjo është e rëndësishme.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit! Dëshiroj t’u rikujtoj kolegëve se pyetjet bëhen në parim, pastaj bëhen nen për nen, kur të vijë diskutimi nen për nen.

**Alfred Çareri** – Është ajo që thashë pak më parë, që kemi rënë dakord me këshilltarët tuaj ligjorë për ta riparë këtë element, për sa thatë edhe ju.

*(Ndërprerje e shkurtër incizimi)*

**Fatmir Xhafaj** – Është propozuar nga relatorja që të ndryshojë kjo dhe ne jemi dakord.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Po, dakord. A ka pyetje të tjera? Në parim kush është dakord? Jo, më falni! Më falni! Pyetje s'ka më. Diskutime?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Po.

**Nard Ndoka** – Faleminderit zoti kryetar! Kuptohet se mungesa e zbatimit të këtij ligji ka qenë kryesisht nga mosvjelja e gjobave. Ky ka qenë problemi kryesor, që gjobat e vendosura nga inspektorati pothuajse në asnjë rast nuk janë vjelë. Në qoftë se do të flasim për një lloj përmirësimi...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Duhet të ishit kryesisht të përqendruar te zbatimi i ligjit në praktikë, pra që të ketë një bashkëpunim edhe me Policinë e Shtetit, edhe me policitë bashkiake e komunale, e kjo është, besoj, thelbi i përmirësimit të këtij ligji. Këto janë shtesa që ju keni marrë një eksperiencë. Ai ligj është përgatitur sipas standardeve evropiane, madje i mirëstudiuar. Ju bëni disa hapa mbrapa dhe merrni një eksperiencë të Kosovës, si zbatohet ligji në Kosovë, dhe do ta ndryshojnë ligjin sipas ligjit të Kosovës, në një kohë që nuk ka lidhje fare me pjesën e zbatimit.

Cila është ajo zgjidhje që ju i keni dhënë që këto gjoba që vihen nga inspektorati të vilen? Kjo është kryesorja për disiplinimin e shkelësve të këtij ligji. Unë nuk shikoj ndonjë masë konkrete. Është diskutuar që në miratimin e këtij ligji që të kishte kompetencë edhe Policia e Shtetit, edhe Policia Bashkiake, pasi i kanë të gjitha mundësitë të koordinohen, të kenë aksione të përbashkëta dhe ta kenë në qendër të vëmendjes vjeljen e këtyre gjobave. Sado që t'i jepet kompetencë inspektoratit, është e pamundur edhe për vetë funksionimin e tij me një numër shumë të vogël për autoritetin e tij dhe të cunguar. Besoj se nuk keni bërë ndonjë gjë, përveçse keni përmirësuar disa terma në këtë legjislacion, por jo për t'i dhënë realisht një zgjidhje zbatimit të këtij ligji.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem, keni ndonjë koment?

**Alfred Çareri** - Është si komenti i mëparshëm. Nuk mund të them asgjë më tepër për aq kohë sa do ta rishikojmë përsëri sipas fjalës që tha edhe relatorja. Ndërkohë që rashë dakord edhe me këshilltarin e komisionit për ta riformuluar këtë nen.

**Fatmir Xhafaj** – Pyetjet mbaruan. Ka diskutime?

Po, zoti Vasili.

**Petrit Vasili** - Unë kam dy-tri gjëra për të thënë.

Në radhë të parë, përpara se të vihej në momentin e ndryshimit të këtij ligji, ka pasur një analizë të gjerë dhe të gjatë të situatës, e cila ka buruar edhe kohë më parë idenë për të ndryshuar dhe rishikuar ligjin. Nuk ka qenë dhe nuk është thelbi i ligjit vjelja apo jo e gjobës, me thënë të vërtetën. Ne këtu po i drejtohem zotit Çareri, por besoj se është personi më i përshtatshëm në këtë punë, sepse grupi i punës duhet të ketë pasur të tjerë ideatorë, duhet të kishte njerëz nga shëndeti publik, nga ata që janë marrë nga grupi i punës, pavarësisht personave politikë. Pra, po bëjmë disa konstatime dhe nuk po i referohemi fare prezencës së tij, sepse po i bëjmë pyetje dhe sugjerime që nuk kanë lidhje me të. Problemi kryesor ka qenë, pasi ka pasur një pyetje në tavolinë: Shqipëria do ta përvetësojë mentalitetin e ambienteve të diferencuara? A do të bëjë Shqipëria ambiente të veçanta jo stimuluese për duhanpirjen? Kjo ka qenë një nga pyetjet e para. Kjo pyetje e madhe nuk ka përgjigje.

Pyetja e dytë që ka qenë shtruar në raport me gjetjen që kanë pasur mbi shpeshësinë e duhanpirjes: ku do të orientohet kryesisht veprimi dhe cilin do të mbrojë?

E treta, nuk është parë dhe nuk është konstatuar se rritjet ekstreme të masës së gjobës janë ato që krijojnë efektivitetin maksimal, por ka qenë konstatuar që gjobat mund të jenë shumë më të ulëta, por efektiviteti në vjeljen e tyre mund të japë efikasitet shumë të lartë.

E vërteta është që këto pyetje të mëdha, të cilat kanë qenë konstatime që dikur një grup pune i gjerë bëri për ligjin, i vuri në tavolinë për zgjidhje dhe ky draft nuk i kthen asnjë përgjigje. Në thelbin e tij, është po i njëjti ligj, janë po të njëjtat gjetje dhe po të njëjtat situata. Me thënë të vërtetën, një gjobë që shkon nga një milion lekë në një milion e gjysmë nuk më jep zgjidhjen e problemit. Ligji nuk ofron risitë e karakterit në ndryshimin e mentalitetit apo në orientimin në një drejtim të ri që e bën efektive këtë gjë. Hajdeni të bëhemi shpresëmëdhenj për këtë decentralizim total të inspektorateve, që për mua është një shpërqendrim i plotë i vëmendjes, pasi duhet të ndodhte e kundërta. Veprimet duhet të ishin shumë më të përqendruara, sepse është si ajo shprehja që thonë: “Fëmija me shumë mami del sakat”. Hajdeni të shpresojmë

te ky eksperiment shumë i shpërqendruar. Përderisa ne gjejmë të tilla konstatime që AKU-ja duhet të kontrollojë në një restorant për duhanin, besoj se janë gjetje të çuditshme që nuk na çojnë gjëkund, por hajde të besojmë në një vullnet të mirë dhe të konsumojmë edhe këtë eksperiment të radhës, ndonëse unë mendoj se pyetjet që kanë qenë shtruar duhet të merrnin patjetër përgjigje dhe në mënyrë të veçantë në ambientet e diferencuara. Ato nuk ekzistojnë për duhanpirësit. Ekzistojnë në aeroportet më të mira të botës, por nuk ekzistojnë në Shqipëri. Ekzistojnë në shtete me politika shumë të forta kundër duhanit, por nuk ekzistojnë në Shqipëri. Mendova se kjo gjë do të kishte një përgjigje, aq më tepër që kundërthëniet e mia të opinionit dhe asaj që ndodh normalisht janë të mëdha dhe kërkonin një përgjigje edhe ligjore të ishte, edhe praktike, edhe funksionuese.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Vasili!

Zoti Majko, për një vlerësim në parim.

**Pandeli Majko** – Unë mendoj se projektligji që po diskutojmë sot, në fakt, është, me pak humor, një nga ligjet që e kemi trajtuar si simbol të mosfunksionimit në Shqipëri. Nëse doni të shikoni funksionimin e këtij ligji, ejani në kafenenë e Kuvendit dhe shikoni sa e zbatojnë ligjin deputetët e Kuvendit.

Do të më falni tani...

*(Debat në sallë.)*

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem, kolegë!

**Pandeli Majko** – Në vazhdim të asaj që tha zoti Vasili, si ligjvënës duhet të pranojmë disa realitete, jo të miratojmë disa shkronja të hedhura mbi faqe A4. Ky ligj nuk zbatohet dot në Shqipëri. Ky ligj është i dështuar në Shqipëri. Ky ligj vetëm sa ka pjellë një korrupsion të caktuar, ku në disa lokale lihet të pihet duhan, në disa të tjera nuk lihet të pihet duhan. Ne i vëmë tani edhe një gjobë prej 50 000 lekësh të vjetra atij që e gjejmë duke pirë duhan në lokal.

Unë e kuptoj, por besoj se 90% e atyre që pinë duhan në një lokal të caktuar janë hallexhinj. Një paketë bën 2000-2500 lekë të vjetër; tani ne shkojmë dhe i këpusim edhe 50 000 lekë të vjetër. Besoj se më mirëkuptoni.

Ajo që tha zoti Vasili për ambientet e diferencuara është gjëja më me mend që ne mund të diskutojmë në këtë histori, të paktën të mos kalojmë nga një pozicion në një pozicion ekstrem që e kemi kopjuar nga diku, sepse realisht kemi dështuar. Prandaj, me keqardhje, unë do të

abstenoj për këtë projektligj. Projektligj sa për të kaluar radhën, nuk kemi pse diskutojmë. Nuk i përshtatet ambientit të Shqipërisë; nuk funksionon. Kur nuk funksionon në Kuvendin e Shqipërisë, çfarë të diskutojmë ne për lokalet dhe restorantet e Shqipërisë? Çfarë do të diskutojmë ne për historitë e natyrave të tjera? Hajde të diskutojmë për ambiente të ndara, të diferencuara siç e ka bota, ose ta shikojmë: një lokali që do t'i lejojmë duhanin, të paguajë edhe një taksë më tepër sesa ai ku nuk lejon duhanin dhe të shikohet kjo histori edhe si një sistem fiskal më vete. Jam i bindur se kështu do të funksionojë. Si ligj me moral: jo po të bën dëm për shëndetin, jo kështu; hajde heqim alkoolin atëherë; hajde heqim edhe ndonjë gjë tjetër dhe themi: bën dëm për shëndetin. Sa gjëra bëjnë dëm për shëndetin. Prandaj, do të më mirëkuptoni, e kam me dëshirën e mirë që ka ky projektligj edhe për të rregulluar disa probleme të natyrave të ndryshme që ka nga projektligji tjetër, por gjithçka mbetet në sensin teorik. Ne sot për ligjin bazë që po ndryshojmë, duhet të pranojmë një realitet: është i dështuar. Ne jemi komision që japim mendim dhe jo komision që vendosim, por ky është realiteti.

*(Mbledhjen e drejton zoti Subashi.)*

**Armando Subashi** – Faleminderit, zoti Majko!

Po, zonja Caka.

**Silva Caka** – Faleminderit!

Së pari, do të doja të përgëzoja Këshillin e Ministrave për faktin që ka shtuar organet kompetente për kontrollin e zbatueshmërisë së ligjit, pasi kemi qenë vetë dëshmitarë të asaj çfarë ka ndodhur kur kemi pasur vetëm një Inspektorat që kontrollonte zbatueshmërinë e ligjit! Një inspektorat i vetëm krijonte mundësinë për t'u korruptuar punonjësit, inspektorët e tij. Kemi qenë vetë prezentë nëpër lokale, nëpër bare kur kamerierët ose punonjësit e bareve vinin të na largonin tavllat ose të na njoftonin: “Ju lutem, mos pini më duhan, sepse po vijnë inspektorët!” Pikërisht, shtimi i këtyre organeve që kontrollojnë zbatueshmërinë e ligjit kam përshtypjen se shmang edhe mundësinë për t'u korruptuar inspektorët që kontrollojnë.

Sugjerimi im do të ishte të rishikohet mirë plani i masave nëpër pabe. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që pabet janë vendi ku konsumohet më shumë cigare se në çdo vend tjetër, madje edhe personat që nuk e pinë, që nuk e konsumojnë rregullisht cigaren në ambientet e pabeve, ndoshta të shtyrë edhe nga efekti i alkoolit dhe muzikës së lartë, e konsumojnë atë. Prandaj mendoj se plani i masave nëpër pabe duhet të rishikohet me detaje dhe masat të jenë ndoshta më të forta për zbatueshmërinë, pasi mendoj se nuk ka për të pasur efektivitet.

Faleminderit!

**Armando Subashi** – Faleminderit!

Ka diskutim tjetër? Po, zoti Ndoka.

**Nard Ndoka** – Faleminderit!

Me sa mora vesh, është sekretari i Përgjithshëm i ministrisë. Atëherë ka një grup pune që ka punuar për hartimin e këtij ligji dhe ata e mbrojnë me fanatizëm për faktin që është një ligj që kërkohet nga Bashkimi Europian: plotësimi i standardeve tona, ndaj jemi të detyruar për ta zbatuar këtë ligj. Ka pasur tendenca edhe më përpara, që të jemi krejt të qartë, zoti Majko, që të jetë me ambiente edhe brenda për brenda lokaleve dhe me sipërfaqe të kufizuar dhe në mënyrë kategorike është ndaluar një gjë e tillë. Pra, të kemi ambiente të diferencuara, qoftë edhe pagesën e taksave ose ambiente që kanë aspirator, sepse janë modele të dështuara edhe në vendet e Bashkimit Europian, të cilat e kanë plotësuar.

Për sa u takon aeroporteve, Bashkimi Europian i ka lënë hapësirë këtij ligji. Për aeroportin tonë ne do të shohim masat për zbatimin e këtij ligji dhe jo liberalizimin e tij, do të shohim masat për zbatimin e këtij ligji, dhe jo liberalizimin e tij. Kjo besoj është detyra e një qeverie. Nëse qeveria aktuale nuk ka mundësi të zbatojë një ligj të tillë të domosdoshëm për shëndetin publik, për të drejtat e njeriut – një njeri që pi duhanin shkel të drejtat e tjetrit, madje e dënon me vdekje, duke tymosur nëpër ambiente publike – do t’ju kërkoja që të mos bëni hapa prapa, me gjithë populizmin që e keni dëshirë në raste të veçanta. Është e pamundur që ky ligj të kthehet mbrapsht.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

I mbyllim diskutimet këtu.

Kush është pro në parim? Kundër? Abstenim? 3 abstenime.

Miratohet.

Faleminderit!

Para se vazhdojmë shqyrtimin nen për nen, në parim jam dakord me ato që u thanë: ky ligj ka nevojë të përmirësohet. Kjo nuk është detyra e këtij Komisioni, por e atij përgjegjës. Relatori dhe këshilltarët t’i mbajnë shënim të gjitha vërejtjet, t’i sistemojmë dhe t’ia kalojmë komisionit përgjegjës, që t’i marrin në shqyrtim, duke parë mundësinë për t’i reflektuar konkretisht nen për nen.

Zoti Klosi.

**Bledi Klosi** – Zoti kryetar, duke shprehur edhe një herë dëshirën e madhe që ky ligj të implementohet, për procedurë do t’ju kërkoja si kryetar i këtij Komisioni, të kemi mundësinë e një konsultimi, qoftë brenda Grupit Parlamentar të PS-së, qoftë me Ministrinë e Shëndetësisë, apo dhe brenda Komisionit, para se të kalojmë nen për nen, nëse kemi mundësinë që ky ligj të përmirësohet. Nëse është e mundur, deri pasdite.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Lutaj.

**Piro Lutaj** – Kam të njëjtën gjë. Siç shihet, po diskutojmë që ky ligj të rishikohet nga komisioni përgjegjës. Para se të marrim konkluzionet e tij, të bëhet kjo konsulta dhe pastaj të hyjmë nen për nen. Kam idenë që do ta kalojmë nen për nen, mund të lini dhe debate, por nuk bëjmë asgjë.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe një herë një gjë që duhet mbajtur në konsideratë: fakti që nuk jemi komision përgjegjës është gjë e rëndësishme. Seancës, ndryshimet do t’ia paraqesë komisioni përgjegjës. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Ne i themi komisionit përgjegjës se cilat janë mendimet dhe gjykimet tona për të reflektuar komisioni përgjegjës. Gjithsesi, meqë ju kërkon që të reflektoni dhe ju vetë mbi përmbajtjen e këtyre neneve, përpara se t’i kalojmë nen për nen dhe në tërësi, nuk kam asnjë kundërshtim. Ndërkohë, do t’i lutesha relatores që, së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe këshilltarët, nën drejtimin e këtyre të fundit, të ulen urgjentisht të marrin në konsideratë çfarë vërejtjesh dhe sugjerimesh u dhanë për të parë mundësinë e reflektimit, por gjithmonë për t’i dhënë si mendime për komisionin përgjegjës, në mënyrë që në seancën në vazhdim ta kalojmë nen për nen dhe në tërësi, duke i dhënë kohë dhe mundësi komisionit përgjegjës që ta shqyrtojë. Duhet të keni parasysh që kjo duhet të mbyllet sot, për shkak se ky është të enjten në seancë plenare. Do të thotë që komisioni përgjegjës duhet ta shqyrtojë nesër. Pra, mendimet dhe sugjerimet tona duhet t’ia çojmë sot.

Atëherë, në 16:30, është mbledhja e Komisionit, sipas rendit të ditës që keni në kalendarin e Komisionit që u miratua sot.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Keni të drejtë: në orën 17:00. Kemi rënë dakord me nënkryetarin e KQZ që ta shqyrtojmë nesër, meqë do të jetë edhe ai në seancë për ta shqyrtuar.

Faleminderit! E mbyllim për sot.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 07.07.2014 ora 17:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar”.
3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar”.
4. Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Edi Paloka, Kastriot Islami, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Silva Caka, Keltis Kruja, Tahir Muhedini, Eduard Halimi, Tom Doshi dhe Mark Frroku.

**Mungojnë:**

Dashamir Peza, Spartak Braho, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Gent Strazimiri dhe Arben Ristani.

**Të ftuar:**

Andoneta Njehrrëna – drejtore Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë

Gazmend Bejtja – drejtor i Shëndetit Publik

Arben Isaraj – zëvendësministër i Drejtësisë

Edlira Jorgaqi – drejtoreshë e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

## **HAPET MBLEDHJA**

**Fatmir Xhafaj** – Tani do të vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.

Neni 1.

A jeni dakord me vërejtjet e paraqitura nga relatorja? Kundër? Nuk ka.

A jeni dakord me nenin 1? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush ka pyetje, vërejtje, sugjerime?

**Silva Caka** – Ne sugjerojmë që në germën “dh”, pas fjalës “mjediset” të shtohet edhe fjala “ të mbyllura”, për të bërë cilësimin midis mjediseve të hapura dhe atyre të mbyllura në bazë të sugjerimit që u bë nga njëri prej kolegëve, për të bërë diferencimin midis stadiumeve dhe ambienteve sportive të mbyllura.

**Fatmir Xhafaj** – A jeni dakord me vërejtjen e relatores? Dakord.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Ka vërejtje, sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4.

**Silva Caka** – Në nenin 4 komisioni ka disa riformulime, konkretisht germat “g”, “gj”, “h”, “i” dhe “j”.

Germa “g” të riformulohet në këtë kontekst: “Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake ose Komunare për shkeljen e germës “ç” të nenit 15”.

Germa “gj” riformulohet: “Inspektorati që mbulon fushën e punës, inspektorati që mbulon fushën e shëndetit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për shkeljen e germës “d” të nenit 15”.

Germa “h” riformulohet si më poshtë: “Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit dhe inspektori i policisë së zonës për shkeljen e germës “dh” të nenit 15”.

Germa “i” riformulohet: “Policia Bashkiake ose Komunare dhe inspektori i policisë së zonës për shkeljen e germës “e” të nenit 15”.

Germa “j” riformulohet si më poshtë: “Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit për shkeljen e germës “ë” të nenit 15”.

Pika 2 e këtij neni riformulohet: “Trupat inspektuese të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni e ushtrojnë kompetencën që u jep ky ligj bashkë me detyrat funksionale të fushave të veprimtarisë së tyre

inspektuese. Trupat inspektuese, sipas përcaktimit të këtij ligji, bëjnë verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10433, datë 16.06.2013 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.”.

Pika 3 riformulohet si më poshtë: “Inspektorati qendror bashkërendon veprimtarinë inspektuese të trupave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Ngarkohet inspektorati që mbulon fushën e shëndetit për monitorimin dhe zbatimin e këtij ligji”.

**Fatmir Xhafaj – Faleminderit!**

A keni vërejtje?

Përfaqësuesit e ministrisë, a jeni dakord?

**Gazmend Bejtja – Dakord.**

**Fatmir Xhafaj – Faleminderit!**

Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6.

**Silva Caka –** Për nenin 6 kemi propozuar që të numërohet neni 5, sipas renditjes së neneve në projektligj. Pra, është bërë një gabim dhe duhet të numërohet si nen 5. Njëkohësisht, për këtë nen kemi vendosur të bëjmë një propozim në lidhje me vendosjen e gjobave të parashikuara në këtë nen të projektligjit. Ne propozojmë që të ulet masa e gjobës vetëm për kategorinë e duhanpirësve.

**Fatmir Xhafaj –** Sa duhet të bëhet masa?

**Silva Caka –** Ne thjesht kemi bërë propozimin për komisionin përgjegjës ose për ministrinë, nëse ata vijnë me një propozim. Arsyeimi për këtë ndryshim ka qenë se duhanpirësit janë “rrjedhojë e politikave” që ndjek menaxheri, pronari ose drejtuesi i institucionit ose barit, apo të gjitha kategorive të mjedisve të mbyllura që kemi cilësuar në këtë ligj. Pra, gjopa duhet të ndryshojë vetëm për kategorinë e duhanpirësve, jo për ata që drejtojnë mjedisin e mbyllur, ku nuk lejohet pirja e duhanit.

Në lidhje me ankimimin për propozimin që bëri zoti Subashi, ai parashikohet në pikën 3 të nenit 6, duke iu referuar ankimimit sipas ligjit kuadër të inspektimit dhe legjislationit në fuqi, që përmbledh

ankimimin tatimor dhe doganor të vendimeve të Policisë Bashkiake ose Komunare dhe Policisë së Shtetit, që rregullohen me ligje të veçanta. Ne propozojmë që në pikën 3 të shtohet një fjali, për ta bërë më të qartë pikën e këtij neni, ku të thuhet: “Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ të bëhet ankimim në Gjykatën Administrative, brenda afateve dhe procedurave të parashikuara në dispozitat e ligjit nr. 49 të vitit 2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative”, gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”. Ky është një tjetër propozim që bëhet në lidhje me ankimimin.

**Fatmir Xhafaj** – Përfaqësuesit e ministrisë?

**Gazmend Bejtja** – Përderisa nuk e cenon propozimin në thelb, ne jemi dakord për të diskutuar për detajet e vlerës së gjobës, për kundërvajtësin individual, si dhe për ta shtuar fjalinë edhe më tej në lidhje me procedurën e ankimit, ndonëse kjo procedurë në lidhje me rezultatet rregullohet me ligjin horizontal për inspektimin dhe ligjin për kundërvajtjet administrative.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe ministria është dakord.

Zoti Majko, keni fjalën.

**Pandeli Majko** – Për sa i përket problemit të gjobave, dëshiroj të nënvizoj faktin se ato janë shumë të larta. Ju e dini shumë mirë që në praktikën e përditshme gjobat e larta krijojnë këtë cilësi: nuk vilen. Në mënyrë të përgjysmuar ose vjetore i jepet diçka në dorë inspektorit dhe në këtë mënyrë ato shlyhen. Kështu funksiononte në kohën e regjimit të mëparshëm. Shqipëria kaq është dhe e dimë të gjithë sesi funksionon.

Te germa “a” thuhet se, nëse kapet një duhanpirës, ai dënohet me 5 mijë lekë të rinj gjobë.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Caka propozoi që të ulet.

**Pandeli Majko** – Unë propozoj që të gjitha gjobave t’u hiqet një zero.

Së dyti, në frymën e asaj që diskutuam sot, zonja Caka të më falë, sepse foli pak shpejt dhe nuk ishte e qartë, mbase ngaqë është pasdite, ne lejuam që të jepet një lloj licence për të gjitha lokalet, restorantet apo vendet që ofrojnë shërbime, të cilat të kenë mjedise të caktuara për pirjen e duhanit. Ne nuk po krijojmë një praktikë thjesht për të kënaqur shqiptarët, por është një gjë që funksionon në të gjitha vendet ku ndalohet duhani, duke filluar nga aeroportet dhe të gjitha me radhë.

Ne do të vazhdojmë të kemi këtë lloj kategorie restorantesh dhe lokalesh, që funksionojnë në mënyrë informale, duke i lejuar klientët të pinë duhan, apo do ta japim me licencë, ku edhe shteti të përfitojë, edhe këto histori të mos kthehen në histori informale? Çfarë mendimi ka ministria?

**Fatmir Xhafaj** – Urdhëroni!

**Petrit Vasili** – Unë pata mundësinë ta diskutoja këtë edhe në Komisionin e Shëndetësisë, që është komisioni përgjegjës. Një nga arsyet pse nuk ka sens mbajtja e gjobave shumë të larta është pikërisht sistemi i gjobave, i cili ka qenë i lartë. Kohë më parë u vendos që gjobat të konsideroheshin me titull ekzekutiv. Kjo gjë, pavarësisht se kishte edhe një mekanizëm më të mirë të vjeljes së tyre, nuk është se e rriti mundësinë e vjeljes së saj më tepër. Pra, edhe ky ndryshim i rëndësishëm nuk e solli këtë gjë. Prandaj mbajtja e gjobave gjithnjë e më të larta është marzhi i një fiktiviteti të lartë, i cili nuk ka ndonjë funksion real dhe shanset për t'u përsëritur e njëjta histori janë po të njëjta. Ndërsa gjobat që kanë një masë më me kuptim dhe më të realizueshme do të ishin vërtet një masë që do të godiste tamam. Prandaj rishikimi i gjobave, duke ruajtur gjoba pak më të ulëta, mendoj se do të ishte një qëndrim më realist për këtë punë. Kështu që mendoj se masa e tyre duhet riparë edhe në komisionin përgjegjës, në mënyrë që të jenë efektive. Mekanizmi është i njëjtë dhe nuk ka ndonjë shans të ndryshojë vjelja e tyre.

**Blendi Klosi** – Unë kam një pyetje të thjeshtë. Do të gjobitet duhanpirësi, si do t'i vilet gjoba e tij? Kush do t'ia vjelë?

**Fatmir Xhafaj** – Zoti drejtor, ju lutem, një koment për shqetësimin e ngritur nga zotërinjtë Majko, Vasili dhe Klosi, që në thelb është i njëjtë, po ashtu edhe për pyetjen e zotit Klosi, me të cilën edhe unë jam dakord.

**Gazmend Bejtja** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me mundësinë për lejimin e disa ambienteve për pirjen e duhanit, përpos ambienteve ku nuk lejohet duhanpirja, sigurisht që ka eksperiencë të ndryshme botërore dhe europiane, çështja është që Shqipëria ka ratifikuar konventën kuadër për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit në 2006-n. Duke qenë shtet palë, angazhohet që të mos e lejojë duhanpirjen në ambiente publike të mbyllura. Nga pikëpamja parimore, Ministria e Shëndetësisë i mëshon faktit që e drejta e qytetarit, i cili nuk është duhanpirës prevalon mbi “të drejtat” e duhanpirësve për të konsumuar një produkt, që është legal, por që nuk është i domosdoshëm. Ky është qëndrimi i Ministrisë së Shëndetësisë për këtë çështje.

Në lidhje me nivelin e gjobave, niveli i gjobave është i krahasueshëm me atë që është edhe në Kosovë, si dhe me nivelin e gjobave që aplikohen për kundërvajtje të tjera administrative në fushën e inspektimit sanitar apo për kundërvajtje të tjera të ngjashme. Gjithsesi, vlera e gjobës mund të diskutohet nëse jemi për penalizim apo sensibilizim dhe ndërgjegjësim.

Në lidhje me vjeljen e gjobës së individit, për herë të parë në këtë projektligj propozohet edhe një masë administrative për individin që konsumon duhan në ambientet ku nuk lejohet, kryesisht në ambientet publike të mbyllura. Sigurisht, kjo është risia kryesore e këtij projektligji. Në fakt, më parë duhanpirësi është konsideruar si një viktimë e vesit të tij dhe si i tillë nuk kishte arsye të dënohej. Ndërkohë nga shumë aktorë është kërkuar që ligji nuk ka qenë efektiv, sepse duhanpirësi nuk është penalizuar. Në grupin e punës është diskutuar me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, me përfaqësuesit e përmbartimeve të ndryshme private dhe me Policinë e Shtetit dhe në çdo rast është menduar se, nëse individit nuk paguan vullnetarisht masën, që në këtë projektligj është 5 mijë lekë të rinj, atëherë i kërkohet karta e identitetit dhe më pas hyn në lojë përmbartimi për t'ia vjelur këtë gjobë. Në fakt, nga konsultimet që kemi pasur me përmbartuesit ata janë shprehur se kjo është e mundur.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Doshi, keni fjalën.

**Tom Doshi** – Unë propozoj që kafe dhe restorante të veçanta të kenë leje, siç është në të gjithë botën, sepse kjo bëhet për shqetësimin e atyre njerëzve që nuk pinë duhan, të cilët ankohen. Nëpër aeroporte ka vende të caktuara për duhanpirësit. Kështu që edhe në Shqipëri një bari apo restoranti duhet t'i jepet një licencë për lejin e pirjes së duhanit. Nuk ka pse të penalizohet pronari i lokalit nëse temperaturat janë -10 gradë dhe një duhanpirësi i duhet të dalë jashtë që ta pijë cigaren. Unë vetë nuk jam duhanpirës dhe nuk shkoj në një ambient, që është i licencuar për pirjen e duhanit. Për shembull, në Holandë ka ambiente ku pinë hashash, por në ato ambiente nuk shkon e gjithë Holanda. Ai që është përdorues hashashi shkon te lokali i tij. Nuk ka pse të penalizohet i gjithë biznesi apo të gjithë qytetarët. Unë propozoj që të kenë licenca të veçanta lokale ose restorante për pirjen e duhanit.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Kush e do fjalën tjetër?

**Nard Ndoka** – Ky ligj është marrë nga eksperiencat më të mira europiane.

Së dyti, është një obligim i Shqipërisë për miratimin e këtij ligji, sepse është marrë eksperiencia më e mirë.

Është e vërtetë që disa vende e kanë provuar diçka të tillë, që t'i ndajnë ambientet brenda një restoranti, ku një pjesë të jetë me aspirator për duhanpirësit, por ka rezultuar e dështuar, sepse nuk është zbatuar ligji, niveli i ndotjes ka qenë shumë i lartë dhe ka krijuar probleme të mëdha. Ka pasur vende që e kanë provuar edhe me licenca për lokale të ndryshme, por moszbatimi i ligjit ka krijuar probleme edhe te konkurrenca, sepse ai mund të paguajë një taksë më të lartë për duhanpirësit dhe në një kohë është pirë duhan edhe në një lokal tjetër që nuk e ka paguar atë taksë. Pra, krijon probleme jashtëzakonisht të mëdha.

Efekti i këtij ligji është të vendoset një standard dhe një kulturë edhe për qytetarët, sepse duhanpirësit dëmtojnë shëndetin e atyre që nuk e pinë duhanin. Në njëfarë mënyrë kjo është një masë parandaluese edhe për ata që e pinë. Për shembull, të vendosen rregulla që punëdhënësit brenda tetë orëve të disiplinohen dhe të kenë vetëm një 5 minutësh për pirjen e duhanit. Kjo është edhe një masë parandaluese, sepse ul numrin e duhanpirësve dhe të cigareve që duhanpirësit pinë gjatë ditës. Ajo e ndalon në mënyrë kategorike pirjen e duhanit në vendet publike. Pra, këto eksperiencia janë marrë nga disa vende dhe është marrë varianti më i mirë. Nëse ne bëjmë hapa mbrapa edhe me nivelin e uljes së gjobave dhe me liberalizimin e vendeve, besoj se e dëmtojmë këtë ligj, por do të ketë edhe sanksione. Pavarësisht se ju nuk i keni jetuar ato kohë, kjo ka qenë kërkesa kryesore për plotësimin e disa standardeve, ashtu siç ka edhe të tjera. Kështu që besoj se do të jetë një veprim që do të ketë kritika maksimale jo vetëm nga realiteti ynë, por edhe nga ndërkombëtarët.

**Fatmir Xhafaj** – A keni gjë tjetër për këtë nen?

**Tom Doshi** - Nardi e kishte për duhanin, jo për puron. Kështu që ne për puron mund ta lejojmë.

**Fatmir Xhafaj** – Kush është dakord me nenin 6, me sugjerimet që u bënë, që t'ia kalojmë komisionit përgjegjës? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7.

Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është me dakord projektligjin në tërësi, si dhe me vërejtet dhe sugjerimet që t'ia kalojnë komisionit përgjegjës? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me vërejtjet dhe sugjerimet për t'ia kaluar komisionit përgjegjës.

Këshilltarja bashkë me relatoren ta mbyllin sot këtë gjë, meqenëse nesër Komisioni i Shëndetësisë, që është komision përgjegjës, do ta diskutojë këtë projekt bashkë me sugjerimet që u bënë.

Falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë!

**Pandeli Majko** – Vërejtjen e gjobës e kemi shumë problem, sepse 5 mijë lekë të rinj të bien pas qafe dhe do të bëhen hallexhijntë me hije.

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem, kijeni parasysh!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

## KUVENDI

### *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Dokument parlamentar

## PROCESVERBAL

Datë 07.07.2014 ora 17:22

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar”.

### **Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Edi Paloka, Kastriot Islami, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Silva Caka, Keltis Kruja, Tahir Muhedini, Eduard Halimi, Tom Doshi dhe Mark Frroku.

### **Mungojnë:**

Dashamir Peza, Spartak Braho, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Gent Strazimiri dhe Arben Ristani

### **Të ftuar:**

Arben Isaraj – zëvendësministër i Drejtësisë

Edlira Jorgaqi – drejtoreshë e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

**Fatmir Xhafaj** – Vazhdojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar”.

Nga Ministria e Drejtësisë kanë ardhur zoti Arben Isaraj dhe zonja Edlira Jorgaqi.

Faleminderit që jeni të pranishëm!

Secili nga deputetët ka disa vërejtje të përgatitura nga relatorja në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë. Është rënë dakord dhe do ta kemi më të lehtë, sepse është bërë një punë paraprake. Nëse dikush nga kolegët ka diçka tjetër, sugjerimet i keni në tavolinë.

Neni 1, sipas projektit që keni në tavolinë, ku fjalia e parë e nenit 2 riformulohet siç është dhënë aty.

A jeni dakord?

Zonja Jorgaqi, ju lutem!

**Edlira Jorgaqi** – Jemi dakord.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, neni i parë është i shtuar dhe nuk ka lidhje.

**Fatmir Xhafaj** – Kush ka pyetje ose kundërshtime për nenin 1? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1, me vërejtjen që është rënë dakord.

Neni 2, në nenin 10 pas germës “j” shtohet germa “k” me përmbajtjen: “I propozon Dhomës Kombëtare të Avokatisë fillimin e procedimit disiplinor...”.

Zonja Jorgaqi, ju lutem!

**Edlira Jorgaqi** – Duhet hequr fjala “përfshirë”.

**Fatmir Xhafaj** - Bëhet fjalë për nenin 2, në të cilin nuk ka fjalë “përfshirë”, është hequr.

A jeni dakord.

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Kush ka vërejtje ose komente të tjera, përveç këtyre që ka bërë relatorja dhe ka rënë dakord me ministrinë?

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3.

**Vasilika Hysi** – Neni 3, në variantin që ne kemi punuar bashkë me Ministrinë e Drejtësisë, nuk është neni 3 i projektligjit që ka sjellë qeveria. Shqetësimin që ne kemi pasur te pjesa e përkufizimeve, për të përcaktuar se cilat janë subjektet përfituese të ndihmës juridike, e kemi shtuar si një nen të ri, duke garantuar edhe një herë faktin që përfitues të ndihmës juridike janë shtetasit shqiptarë dhe personat e tjerë që ne përmendëm.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Jorgaqi, a jeni dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Jemi dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Kush është dakord me nenin 3, me shtesën e bërë? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3.

Neni 4, pika 1 e nenit 12/1 propozohet të riformulohet.

Zonja Jorgaqi, ju lutem!

**Edlira Jorgaqi** – Jemi dakord.

**Vasilika Hysi** – Neni 4 është neni 3 i projektligjit, i riformuluar.

**Fatmir Xhafaj** – Në variantin që jemi kemi një nen plus, për shkak të shtesës që është bërë.

**Eduard Halimi** – A janë hapur këto klinikat ligjore vendore, apo jo?

**Arben Isaraj** – Komisioni është në proces e sipër për ngritjen e klinikave ligjore.

**Fatmir Xhafaj** – Këtë konfirmim i bënë sot edhe relatores ata.

Kush është dakord me nenin 4, me sugjerimin që u bë? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4.

Neni 5, që ndërhyhet te neni 4 i projektligjit.

**Vasilika Hysi** – Të nderuar kolegë, ky është ndryshimi më i rëndësishëm që ne si Komision i Ligjeve kemi bërë. Duke u bazuar te vërejtjet që kanë bërë OSBE-ja, Avokati i Popullit, organizatat e të drejtave të njeriut, si të gjitha klinikat që japin ndihmë, por edhe te shqetësimi që ngrit komisioneri europian, ne hoqëm kufizimin që mund t’u bëhet subjekteve që e përfitojnë ndihmën juridike për shkak se kanë të ardhura nën pagën minimale. Por kemi futur një model të ri, i cili sanksionon që ndihma juridike mund të jetë e plotë ose e pjesshme, sepse kemi thënë se Komisioni Shtetëror i Ndhmës të vlerësojë rast pas rasti jo vetëm faktin që kërkuesi ka një pagë më të ulët se minimalja, por duhet të shohin edhe pamjaftueshmërinë e tij, sepse mund të ketë persona në ngarkim, por do të shohim edhe përbërjen familjare, statusin shoqëror, si dhe çdo rrethanë tjetër. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë shkallën e kompensimit të ndihmës. Kjo është dhënë te pika 3, por po e them edhe për transparencë për publikun, meqenëse ky dokument nuk botohet në faqen zyrtare të Kuvendit.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Jorgaqi, a jeni dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Kolegët deputetë a kanë gjë për sugjerimin, sepse ky është një nen për të cilin kanë rënë dakord ta riformulojnë për ta sqaruar më mirë, bazuar edhe në sugjerimet e aktorëve të shoqërisë civile dhe OSBE-së?

Kush është dakord me nenin 5? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

**Vasilika Hysi** – Meqenëse në propozimin e qeverisë thuhet se në këto pika fjala “sociale” zëvendësohet me “shoqërore”, do t’ju lutesha që këtë ta bënte stafi e komisionit.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Gjatë zbardhjes do ta kenë në konsideratë.

Neni 6.

A jeni dakord me sugjerimin?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Ministria është dakord me sugjerimin.

Kush ka vërejte ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 6? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 6.

Neni 7, me riformulimin që i është bërë nenit 16.

A jeni dakord me sugjerimin?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – E keni parë riformulimin e ri, bashkë me 9 pikat? Dakord.

Kush ka vërejte ose sugjerime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 7, me riformulimin e sjellë? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Neni 8, me saktësimin e bërë në fund të germës “b” të pikës 2 të nenit 18 me fjalët e shtuara.

Ministria, a jeni dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 8.

Neni 9, me shtesën e pikave 4 dhe 5.

Ministria, a jeni dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Jeni dakord, sepse e keni parë bashkë.

Kolegët deputetë kanë vërejte ose sugjerime? Nuk kanë.

Kush është dakord me nenin 9? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Neni 10, aktet nënligjore.

**Vasilika Hysi** – Te neni 10 përmbajtja është siç e kemi dhënë, por kalon paragrafi i parë: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë akte nënligjore në zbatim të nenit 5/2”, dhe kalon paragrafi i dytë: “Ngarkohet ministri i Drejtësisë që brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi këtij ligji të miratojë udhëzimet e parashikuara”.

**Fatmir Xhafaj** – Ka ndërrim vendesh.

**Vasilika Hysi** – Po.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Jorgaqi, pse duhen 6 muaj për këtë gjë? A nuk mund t’i bëjmë më pak?

**Edlira Jorgaqi** – Është vendosur në bashkëpunim.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

**Vasilika Hysi** – Është lënë 6 muaj, sepse ka ndryshuar skema e pagesës së familjeve që do të përfitojnë.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull, tërhiqem.

Zoti Halimi.

**Eduard Halimi** – Për 6 muaj sa të bëhen aktet nënligjore ky ligj nuk do të hyjë në fuqi, apo do të hyjë në fuqi menjëherë?

**Arben Isaraj** – Atëherë, sigurisht që është i qartë. Gjendja është kjo e sotmja. Në qoftë se janë 6 muaj, janë vënë për gjerat e reja që kemi sjellë në ligj. Nuk është se mungon ndihma. Në qoftë se do të

ketë ndarje të re territoriale, do të ketë **pika** ligjore të veçanta, që në terriore të veçanta do të mbulojë gjëra të veçanta. Sot për sot kemi bërë një studim me të cilin ligji ecën.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, unë pajtohem me shqetësimin e kolegut Halimi. Ndoshta duhet të themi që “...deri në përgatitjen e akteve nënligjore vazhdon zbatimi...”. Duhet të rregullohet që të mos krijohet vakuum ligjor.

**Fatmir Xhafaj** – Çfarë vakuumi? Këto janë nene të reja dhe nuk e pengojnë ligjin bazë të mos funksionojë.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, zoti kryetar, ky është një nen i ri dhe janë bërë rregullime të reja dhe skema e rimbursimit ose e pagimit do të përlogaritët ndryshe nga ç’është bërë sot. Ndoshta kjo lloj skeme do kohë, sepse Këshilli i Ministrave bashkë me Ministrin e Financave do të bëjnë planin. Për shembull, në rast do të vijë një person i ri që ne kemi shtuar, ku do t’i gjejë...

**Fatmir Xhafaj** – Për dy udhëzime bëhet fjalë. Kur të hyjnë në fuqi këto...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Vasilika Hysi** – Shqetësimi është te skema e parave.

**Eduard Halimi** – Ata nuk e bëjnë dot nesër, se kanë skemën e parave....

**Fatmir Xhafaj** – Këto që janë do të qëndrojnë në fuqi.

**Eduard Halimi** – E bëni dot?! S’e bëni dot... Duhet të bëni buxhetin që ta parashikoni...

**Arben Isaraj** – Si bëhej deri më sot pa këtë skemë?

**Eduard Halimi** – Po, pra do të bëni skemën...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar. Për analogji, edhe ligji që është bërë vjet është futur më 1 janar. Pse? Më këtë argument kam ardhur dhe e kam sqaruar këtu. Sepse ky ligj ka efekte financiare. Këto efekte financiare nuk janë parashikuar në buxhetin e vitit 2014. Do të parashikohen në buxhetin e vitit 2015 dhe do të futen, apo nuk është kështu?! Prandaj, hyrja në fuqi duhet të bëhet në vitin **2015**.

**Fatmir Xhafaj** – Kam një pyetje për ministrinë. Çfarë i kushton ministrisë të nxjerrë një udhëzim dhe Këshillit të Ministrave disa akte nënligjore në zbatim të nenit 5/2. Pse të mos shkurtohet kjo kohë?

**Vasilika Hysi** – Personalisht, kam qenë për 3 muaj kohë. Por, duke pasur parasysh që muaji gusht është muaj pushimesh, mbeten vetëm muajt shtator dhe tetor.

E dyta, sipas një komunikimi telefonik shumë të gjatë që kam bërë sot me kryetaren e Komisionit Shtetëror të Ndihmës Ekonomike, fondi total është 98 milionë lekë të vjetër, duke përfshirë edhe stafin. Ndërkohë, deri tani ka 127 kërkesa. Me zgjerimin që ne i kemi bërë rrethit të përfituesve, duke u dhënë mundësi të përfitojnë edhe viktimat e dhunës në familje, edhe viktimat e trafikimit kemi shtuar të miturit viktimë në proceset penale.

**Fatmir Xhafaj** – Ajo nuk ka buxhet. Në qoftë se nuk ka buxhet...

**Vasilika Hysi** – Nuk ka pjesën e buxhetimit.

**Eduard Halimi** – Këtë po them. Pra, rritet gama e tyre, nuk kanë para... Edhe klinikat ligjore nuk i keni hapur, prandaj ju pyeta. Po t'i hapni klinikat ligjore, ju duhet numër i ri punonjësish. Ata punonjës duhen paguar. Aty duhet të ketë zyra. Ju nuk keni fonde të parashikuara për vitin 2014. Prandaj, sigurisht që ligji tani është i pazbatueshëm. Ne mund të shkruajmë që hyn në fuqi pardje, por ai nuk hyn dot në fuqi para 1 janarit. Më 1 janar duhet të hyjë në fuqi.

**Arben Isaraj** – E para, thashë nuk është për ta bërë gjendjen kaq alarmante, se klinikat ligjore duhet të ishin hapur kur është bërë ligji për të cilin zotëria sapo foli, por nuk i kanë hapur. Sigurisht që duhet një studim. Në qoftë se nuk ka ligj, nuk kanë si i hapin. Ne presim gjë tjetër, prandaj është ai gjashtëmujori. Ju i shtuat vetë disa detyra të Këshillit të Ministrave; të gjeni ekspertë të ndajnë edhe brenda familjes se sa janë të ardhurat maksimale, minimale, ose mund të bëhet edhe një përfitim i pjesshëm. Nuk e di, sepse janë gjëra për të cilat duhen studime jo nga ne, por nga specialistët.

**Fatmir Xhafaj** – Ta bëjmë tre muaj.

**Arben Isaraj** – Në qoftë se doni 3 muaj, në rregull. Ju e vendosni.

**Fatmir Xhafaj** – A biem dakord që te neni 10 ta bëjmë 3 muaj? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11. A jeni dakord?

Miratohet.

A jeni dakord në tërësi me projektligjin?

**Vasilika Hysi** – Ka një propozim nga Administrata Publike. Sipas tyre, ligji bie ndesh me ligjin e nëpunësit civil.

**Fatmir Xhafaj** – Pse?

**Vasilika Hysi** – Kolegë, unë i kam bërë një kërkesë Departamentit të Administratës Publike për të parë përputhshmërinë e një neni të këtij ligji me ligjin e ri të nëpunësit civil. Kemi marrë një përgjigje zyrtare. Është fjala për nenin 7 të ligjit, të cilin nuk e kemi sjellë për ta amenduar, pra flitet për sekretariatit teknik të **Ndihmës Juridike** dhe për pagën që duhet të ketë komisioneri i Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike. Sekretariati ndihmës i këtij komisioni është bërë pjesë e shërbimit civil, ndërsa vetë komisioni funksionon dhe organizohet si organ kolegjal, dhe si i tillë, është përjashtuar nga fusha e zbatimit të ligjit të shërbimit civil.

Ndërsa për sa i përket pikës 7 të nenit 6, i cili flet për pagesën e kryetarit të Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike, DAP-i sugjeron të hiqet nga ligji, pasi ka një VKM të vitit 2011. Në vendimin nr. 545, i cili titullohet “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, nëpunësve, zëvendësministrit, nëpunësve të kabineteve të Kryeministrit, aparateve të ministrave të linjës, administratës së Presidentit, të Kuvendit, KQZ-së, Gjykatës së Lartë, Prokurorisë së Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, institucioneve në varësi të ministrave të linjës, të administratës të prefektit” përcaktohet që pagat do të caktohen në bazë të këtij vendimi. Ndërkohë, ligji ekzistues përcakton se paga e kryetares së Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike është baras me pagën e zëvendësministrit. Ky është një problem i cili duhet të diskutohet.

**Fatmir Xhafaj** – Këtë dispozitë rregullojeni dhe silleni në kufijtë sipas ligjit për shërbimin civil.

**Arben Isaraj** – Thotë “paga e zëvendësministrit”. Nuk e di se çfarë duhet bërë më shumë sipas administratës. Ne nuk caktojmë sasinë. Ligji thotë që ka pagën e zëvendësministrit. Nëse paga e zëvendësministrit vendoset me akt ligjor apo me akt nënligjor, siç është VKM-ja, është problem tjetër. Nuk shoh ndonjë shqetësim. Ajo është për t’i dhënë vlerën atij komisioni që të ketë natyrën që meriton.

**Fatmir Xhafaj** – Ajo që kuptoj unë është që komisioni është i rëndësishëm. Pra, është aq i rëndësishëm sa ia kanë bërë pagën kryetarit të barabartë me zëvendësministrin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Lëreni, se nuk është për pagën. **Ka** hierarki një herë. Nuk ka shans. Nuk e kuptoj dot. Megjithatë, kjo është një çështje tjetër dhe nuk do t'i hyjmë kësaj.

**Vasilika Hysi** – E lëmë siç e ka ligji ekzistues.

**Fatmir Xhafaj** – Atëherë, jemi te votimi në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektin, me amendimet e miratuara në komision? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

*Dokument parlamentar*

**PROCESVERBAL**

Datë 07.07.2014 ora 17:40

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Projektligji “Për organizmin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Edi Paloka, Kastriot Islami, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Silva Caka, Keltis Kruja, Tahir Muhedini, Eduard Halimi, Tom Doshi dhe Mark Frroku.

**Mungojnë:**

Dashamir Peza, Spartak Braho, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Gent Strazimiri dhe Arben Ristani

**Të ftuar:**

Arben Isaraj – zëvendësministër i Drejtësisë

Edlira Jorgaqi – drejtoreshë e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

**Fatmir Xhafaj** – Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për organizmin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”.

Fillojmë me shqyrtimin nen për nen, sepse e kemi miratuar në parim.

Neni 1.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, i vetmi ndryshim nga projektligji që ka sjellë qeveria është shtimi i fjalës “shtetërore”. Për saktësi dua një konfirmim nga përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë, sepse në diskutimet që bëmë para mbledhjes thamë ta heqim nga paragrafi i dytë Fletoren Zyrtare, pra ku përkufizohet, meqenëse është përsëritur disa herë në tekst.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Te dokumenti i zbardhur nuk është hequr.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – A jeni dakord me nenin 1?

Zonja Jorgaqi, a jeni dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – A ka vërejtje ose sugjerime nga kolegët? Nuk ka.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2 “Qëllimi”.

**Vasilika Hysi** – Pjesa e nënvizuar është pjesa e riformatuar ose e shtuar nga projekti i qeverisë, duke pasur parasysh edhe opinionet që kanë ardhur nga ekspertë të fushës qoftë nga institucionet shtetërore dhe nga shoqëria civile.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk ka shumë ndryshime.

Neni 2 me ndryshimin e propozuar.

Po, zonja Jorgaqi.

**Edlira Jorgaqi** – Jam dakord, por duhet ruajtur renditja në bazë të alfabetit, se ndoshta nuk është zbardhur ashtu. Për merak, jo për ndonjë gjë.

**Fatmir Xhafaj** – Ne i shqyrtojmë, pastaj për merak...

Ministria është dakord për nenin 2. A kanë kolegët ndonjë gjë? Nuk ka. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 “Përkufizimet”, janë ndryshuar neni 1 “akte të botueshme”, 4, paragrafi i dytë, “arkiva elektronike e akteve” dhe 11-ta “Qendra e Botimeve Zyrtare”. A është dakord ministria, zonja Jorgaqi?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Kolegët deputetë?

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3 me tri ndryshimet e bëra.

Kalojmë te kreu II, neni 4 “Statusi i Qendrës së Botimeve Zyrtare”. Nuk ka ndryshime nga relatorja dhe nga këshilltarët. A jeni dakord me propozimin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 “Përgjegjësitë e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, ku janë ndryshuar vetëm germa “ç” e pikës 1 dhe pikat 6 dhe 7. A jeni dakord?

**Vasilika Hysi** – Pikat 6 dhe 7 kanë qenë si detyrë e renditur në kompetencat që ka drejtoresha e Qendrës së Publikimeve Zyrtare. Ne i kemi dhënë shumë rëndësi dhe kemi thënë: “Qendra e Publikimeve Zyrtare bën ruajtjen e përhershme të dy kopjeve fizike dhe elektronike të çdo numri të Fletore Zyrtare dhe të buletinit të njoftimeve zyrtare. Pra, nuk mund të fillojë fjalia me fjalën “ruajtjen” pa kryefjalë.

E dyta, Qendra e Publikimeve Zyrtare arkivon dokumentet e parashikuara në pikën 6, pra jo në germën “dh”, sepse ka ndryshuar, të këtij neni, si dhe trajtimin e tyre në përputhje me zhvillimet e ardhshme teknologjike. E them këtë, sepse e kemi shkëputur nga pjesa e tekstit.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Jorgaqi, a jeni dakord me komentet?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Është çështje e teknikës.

A jeni dakord me vërejtjet e paraqitura dhe me ndërhyrjet e zonjës Hysi me të cilën bie dakord edhe ministria për nenin 5? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me ndryshimet.

Neni 6 “Fletorja Zyrtare” ka ndryshim të germat “d”/1 dhe “e”. A jeni dakord?

Po, zoti Halimi.

**Eduard Halimi** – Zoti Isaraj, është një pyetje në fakt, të cilën nuk e di si e keni parë, meqenëse nuk keni qenë kur është bërë diskutimi në parim. Shqetësimi ynë permanent, për sa kohë kam qenë aty, lidhur me publikimet zyrtare ka qenë korrupsioni në Qendrën e Publikimeve Zyrtare. Ligji që u bë vjet apo parvjet, kur u bë, kishte si synim jo vetëm një akses më të mirë për qytetarët nëpërmjet publikimit në formë elektronike, por edhe për stokun të krijuar ndër vite, flas për 10-vjeçarën e fundit, për të cilin shteti paguante paratë, të cilin gjyqtarët, kryetarët e komunave dhe bashkive nuk e tërhiqnin, se nuk kishin interes, por krijoi një dëm të jashtëzakonshëm nëpërmjet procedurave të tenderëve që kryheshin nga Qendra. Ky ka qenë një problem permanent. Thashë që ka qenë, e kam gjetur, u munduam ta

hiqnim, por nuk e di si ka vazhduar kohët e fundit. Pyetja ime ka të bëjë me pikën 3 të këtij neni. Në mos gaboj, në ligjin aktual, ai që do të shfuqizohet, thuhet se numri i fletoreve që do të bëhen në letër do të miratohet nga ministri i Drejtësisë, sepse kam menduar kur kam qenë në pushtet dhe mendoj edhe sot që jam në opozitë se përgjegjësinë për ta luftuar korrupsionin e ka ministri. Në qoftë se ne e lëmë që drejtori i Qendrës së Publikimeve Zyrtare të botojë aq numra fletorësh sa të dojë, atëherë do të kthehem aty ku kemi qenë. Në vitin 2005 kemi gjetur 300 mijë kopje aty. Mund të jenë edhe më tepër. Nuk di të them si janë, por ky është një problem. Ndaj, pyetja ime është pse do të duhet t'i lëmë, te pika 3, autoritet Qendrës së Publikimeve Zyrtare dhe pse të mos e ketë këtë të drejtë ministri sa numra do të ketë? Ne themi t'i heqim fletoret zyrtare, se nuk duhen më; sot jemi në kohën dixhitale. Pse i duan kryetarët e komunave? Ata nuk i marrin, kurse shteti paguan. Nuk i marrin gjyqtarët, të cilët i kanë sot në mënyrë elektronike. Ne prandaj e bëmë elektronik sistemin, i cili është bërë, në mos gaboj, në bashkëpunim me francezët.

**Fatmir Xhafaj** – Nuk është kjo. Jo, është neni 6, pika 2.

**Eduard Halimi** – Pika 2: "Fletorja Zyrtare botohet në formë të shtypur nga Qendra e Botimeve Zyrtare në atë sasi që kërkojnë nevojat për kërkesat...". Pra, i lihet autoritet drejtorit. Ta ketë ministri. Nëse do të botohen 100 apo 10.

**Fatmir Xhafaj** – Ministria.

**Arben Isaraj** – Mendojmë t'i decentralizojmë kompetencat. Sigurisht që ky diskutim është bërë edhe në Komisionin e Ekonomisë. Ne jemi dakord që, me rivlerësimin tani, të gjitha institucionet që kanë qenë dakord, janë dakord të heqin dorë nga botimet në ato të famshmet gazeta dhe të gjitha publikimet zyrtare do të shkojnë këtu. Kjo është gjithmonë sipas nevojave. E kemi të argumentuar raportin. Nuk mendoj se edhe ajo drejtoresha do të bëjë korrupsion, por, edhe në qoftë se i jepet kjo kompetencë ministrit të Drejtësisë, ne kemi mundësi të vjelim çfarëdolloj interesi që kanë edhe shtresat në nevojë. Ky diskutim u bë, për të mos e bërë qesharake, *grosso modo*. Në qoftë se Shoqata e të Verbërve nuk hyn dot *online* të shohë çfarë boton, atëherë duhet ta ketë një. Atëherë, ne do të detyrohemi të bëjmë edhe variantin e leximit për ta. Pra, kjo gjë mund t'u lihet në diskrecion atyre, por mund t'i lihet edhe Ministrisë së Drejtësisë. Ne nuk jemi kundër.

**Fatmir Xhafaj** – Bëni një riformulim. A biem dakord, meqenëse edhe zoti Isaraj është dakord me sugjerimin e bërë nga zoti Halimi? Dakord. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni me ndryshimet e sjella në draftin që kemi...

**Vasilika Hysi** – Kemi shtuar vetëm një fjalë. Te paragrafi 1 kemi thënë: “Fletorja Zyrtare është i vetmi botim zyrtar.” Pra, kemi shtuar fjalën “i vetmi”.

**Fatmir Xhafaj** – E miratojmë nenin 6 me ndryshimet e sjella dhe me propozimin që bëri zoti Halimi, me të cilin zoti Isaraj ra dakord.

Neni 7 “Kriteret teknike të botimit në Fletore Zyrtare në formatin letër”; është ndryshuar vetëm stema e Republikës dhe bar-kodi individual për çdo numër.

**Eduard Halimi** – Të njëjtin shqetësim kam edhe këtu. Shqetësimi që ka dalë gjatë këtyre viteve, ka dalë sërish te kriteret e botimit. Përgjegjësinë e formatit, elementet teknike sot, në fakt, me sa duket i ka ministri.

**Fatmir Xhafaj** – I kemi në ligj tashmë.

**Eduard Halimi** – Këto janë vetëm tre. Do t’i shtypin në shtypshkronjën e tyre apo do t’i bëjnë tek të tretët?! Unë e kam pasur problem këtë gjë. E kam pasur problem edhe me këtë zonjën që është këtu, edhe kur kam qenë ministër. Pra, nëse do ta bëjnë me këtë cilësi boje, me këtë cilësi shkrimi, sepse abuzimet në atë qendër kanë qenë elemente të auditit të ministrisë, të KLSH-së në mënyrë permanente. Ndaj, edhe për këtë do të kërkoj që përgjegjësia e miratimit të kriterëve teknike të kalojë te filtri politik, që është ministri, pra ai duhet të mbajë përgjegjësinë për miratimin e kriterëve teknike. E di që edhe kur kam qenë unë ka pasur debate nga ata që kanë qenë. Në ligjin aktual është. Kjo është hequr. Pra, unë di, thashë mund ta kem gabim, se nuk e kam ligjin aktual, por edhe për atë që thashë te neni 6, edhe kjo te neni 7, te ligji aktual e kanë, pra e përqendrojnë kompetencën. Te ligji aktual e përqendrojnë te ministri edhe pjesën e bordit, edhe pjesën e vendimmarrjes.

**Fatmir Xhafaj** – Kam një pyetje, se ndoshta nuk e kuptoj. Ligji e sqaron, pse duhet të hyjë edhe drejtoresha, edhe ministri këtu? Është i qartë, është në ligj: bardh e zi, letër 80 gram/...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Zoti Doshi.

**Tom Doshi** – Zoti Isaraj, kam një pyetje te neni 7: “lidhja”, thuhet, “bëhet me qepje me tel”, po të bëhet me spango, a ka gjë?

**Fatmir Xhafaj** – Të lutem, është teknike!

Zonja Hysi, pyetje.

**Vasilika Hysi** – Unë kam një pyetje lidhur me kapacitetin që ka Qendra e Botimeve Zyrtare. Në fakt, shqetësimi për të cilin foli zoti Halimi ka qenë prej vitesh në qendër. Në dijeninë time, Qendra botonte vetëm Fletoren Zyrtare me argumentin që aparati ose makina e fotokopjes nuk ka kapacitet. Aktualisht, a ka qendra kapacitet për të prodhuar Fletore Zyrtare, si buletinet e njoftimeve zyrtare edhe kodet përmbledhëse të legjislacionit, sepse deri më tani ajo i tenderonte, pra merrte një kompani private, tenderonte dhe i botonin ata fletoret, kodet etj? Nuk flas këtu për shumë të tjerë që botojnë paralel me Qendrën e Publikimeve Zyrtare, por kësaj praktike me këtë ligj i jepet fund.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Isaraj, një koment për të gjitha këto që u ngritën për nenin 7.

**Arben Isaraj** – Komenti është shumë i shkurtër. Në qoftë se nuk e dinë **nëse** është në gjendje ata që e kanë pasur deri dje në varësi atë, që të botojë vetë, kjo është e dukshme, me një fjalë, që nuk është në gjendje të botojë vetë. Risia këtu është që ne kemi vënë kritere. Më në fund kemi vendosur kritere ligjore në ligj. Pastaj, me kapse apo me tel, nuk përmendet fjala “kapse” përmendet fjala “tel”, zoti Doshi, për të treguar siguri.

**Eduard Halimi** – Zoti Zëvendësministër, po të jetë për batuta, i bëj, nuk e kam problem. Kam një pyetje me shumë sinqeritet. Unë kam shkuar dhe e di si funksionon ajo. Besoj se edhe ju keni shkuar. Tani, parashikimi i ligjit që është tani është cedim nga ajo që ishte vjet dhe pse e keni bërë? Nuk besoj se e keni bërë ju, por jua kanë sjellë për ta bërë, por është cedim. E ka pasur ministri në ligj dhe i kalon drejtorit të QBZ-së. Këtë ju e quani risi pozitive, unë them se është mirë siç ishte. Pa fanatizëm, sepse të bëjmë batuta, bëj edhe unë.

**Arben Isaraj** – Unë nuk bëra fare batutë. Unë ktheva një përgjigje të thjeshtë. Nuk kanë qenë kriteret në ligj. Nuk e shikoj se kur i shkojnë këto kritere drejtorit.

**Fatmir Xhafaj** – Ka kritere të tjera? Mund të vendosim një klauzolë: nëse ka nevojë për kritere shtesë, ato mund të bëhen me miratim të ministrit.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon.)*

Zoti Halimi, a mund ta saktësoni me mikrofon, ju lutem?

**Eduard Halimi** – Propozimi im është ky: neni 7 “Kriteret teknike të botimit në Fletoren Zyrtare në formatin letër”, pas pikës 5 të vendoset pika 6: “Të gjitha kriteret e tjera teknike miratohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë”.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Zoti Isaraj, a jeni dakord?

**Arben Isaraj** – Jam shumë dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Edhe zoti Isaraj bie dakord që të rishikohet.

Kush është dakord me nenin 7 bashkë me sugjerimet? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8. Nuk ka shtesa dhe ndryshime. Kush është dakord?

**Eduard Halimi** – Te neni 8 kam një problem që nuk ka dalë më përpara, por çështja e botimit në Fletoren Zyrtare të akteve.

Kemi shqetësimin që shkojnë vendimet e gjykatave, të Këshillit të Ministrave, por nuk botohen. Në qoftë se nuk i çojnë, përgjegjësi kanë ata që nuk i çojnë dhe nuk është çështje e trajtimit të këtij ligji. Unë kërkoj që në këtë nen të bëhet një shtesë, ku të thuhet: “Mosbotimi në Fletoren Zyrtare brenda afateve, siç janë dhënë këtu 5-10-15 ditë...”

**Vasilika Hysi** – E ke te neni 10 shtesën.

**Eduard Halimi** – Ta mbaroj unë, pastaj, nëse e keni ndryshuar dhe është te neni 10, jam dakord. Pra, të përbëjë vepër penale sipas Kodit Penal.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Moskryerja e një detyre të caktuar shtetërore përbën vepër penale, shpërdorim detyre.

Moskryerja brenda afateve, çfarë ndodh? Ka ndodhur që vendime të Gjykatës Kushtetuese nuk janë botuar me radhë vetëm e vetëm të përdoret QBZ-ja si një mekanizëm...

**Fatmir Xhafaj** – E ka Kodi Penal.

**Eduard Halimi** – Nuk po them të vëmë vepër penale të re, por duhet të dihet që duhet të ketë sanksion. Po bëjmë një ligj të ri dhe vendosim rregulla, duhet të vendosim edhe sanksione për moszbatimin e rregullave, sepse pastaj kot që i vendosim ato. Logjika e hartimit të një ligji kështu është: vendosim 5 rregulla, në qoftë se shkelen këto 5 rregulla apo shkelet 1, atëherë ka këtë sanksion, si gjobë, ashtu siç diskutuam për duhanin apo për të tjerët. Kështu bëhet një ligj: vendosen rregulla dhe, nëse shkelen rregullat, ka një sanksion. Ne kemi vendosur që do të bëhet kjo, kjo ... Po në qoftë se nuk bëhet, se e kemi rastin që nuk bëhet, çfarë ndodh? Ndaj, edhe duhet të vendoset kjo. Nëse është në ndonjë nen tjetër, dakord.

**Vasilika Hysi** – Unë kam një shtesë. Shqetësimi që ka zoti Halimi është pasqyruar tek “Afatet e botimit dhe përgjegjësinë që ka”, ku thuhet: “Mosrespektimi i afateve të botimit të përcaktuara në paragrafin etj...”. Pra, është te neni 10.

Ne kemi bërë këtu një shtesë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë lidhur me detyrimin që ka Këshilli i Ministrave, brenda një afati kohe të caktuar, të dërgojë aktet e tij. Gjithashtu, detyrimin që ka kancelari i Gjykatës së Lartë për të dërguar vendimet e kolegjeve dhe të gjykatës dhe të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese”. Kërkoj ndjesë që nuk është zbardhur, sepse është bërë gati!

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Jorgaqi, dakord?

**Edlira Jorgaqi** – Po, ramë dakord me relatoren për këtë gjë.

**Fatmir Xhafaj** – Kush është dakord të miratohet neni 8 me ndryshimin e propozuar? Dakord. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9.

**Vasilika Hysi** – Te neni 9 janë përcaktuar detyrimet...

Kemi vetëm një sugjerim, sepse janë dy tituj. Unë do të isha më shumë për titullin e dytë “Subjektet përgjegjëse për dërgimin e akteve në Fletoren Zyrtare”.

Lidhur me subjektet, janë Presidenti i Republikës, Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, ministritë, sekretarët e Përgjithshëm, për institucionet e tjera është titullari i institucionit, i organit apo i

organizatës që do të nxjerrë aktin. Nuk e di cilin kemi lënë. Lidhur me Gjykatën e Lartë, është harruar, por është kancelari i saj. Për Gjykatën Kushtetuese kemi thënë sekretari i Përgjithshëm. Këto janë ndryshimet që kemi bërë tek të dyja nenet që duhen plotësuar për institucionet.

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Manja.

**Ulsi Manja** – Te pika 1 e nenit 9 thuhet: “Dërgimi i akteve të nxjerra nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, i ministrive për publikim bëhet nga sekretari i Përgjithshëm i Presidencës apo personi i institucionit përkatës.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Fatmir Xhafaj** – Është bërë gabim në atë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

E saktësuam.

**Vasilika Hysi** – Varianti që ne përgatitëm më parë, ishte detajim paragraf për paragraf për çdo institucion. Pra, e kishim: “Dërgimi i aktit të botueshëm, të nxjerrë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, për publikimin në fletoren zyrtare bëhet nga sekretari i Përgjithshëm i Presidencës dhe personi i deleguar prej tij. Dërgimi i ligjeve dhe i akteve të tjera të botueshme të Kuvendit...”

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull!

**Vasilika Hysi** – Atëherë, ka dy variante. Hajde ta vendosim. Doni ta rregullojmë paragraf për paragraf çdo institucion, apo t’i mbledhim këto që kanë të përbashkët sekretarin e Përgjithshëm të institucionit, ndërsa për institucionet e tjera, ku mund të jetë kancelari ose përfaqësuesi i organizatës, t’i kemi paragraf më vete?

Pra, ka dy variante. Këtë e bëmë për ekonomi ligjore, pra që të mos kemi një nen me 11 ndarje.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord!

*(Diskutime pa mikrofon)*

Biem dakord me sugjerimin e bërë nga zonja Jorgaqi?

Dakord. Kush është dakord? Miratohet neni 9.

Vazhdojmë me nenin 10, me ndryshimin e bërë te pika 3, dakord zonja Jorgaqi?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Vasilika Hysi** – Te pika 2 duhet saktësuar. Ne kemi bërë këtë shtesë: “mosrespektimi i afateve të botimit, të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni ngarkon me përgjegjësi administrative titullarin e Qendrës së Botimeve Zyrtare..”, por mund të ndodhë që nuk ka ardhur botimi në kohë nga institucionet. Edhe ata do të kenë përgjegjësi administrative për mosdërgimin në kohë të aktit për botim.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord!

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Eduard Halimi** – Pra, kur nuk përbën kundërvajtje, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative.

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Jorgaqi?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord!

**Fatmir Xhafaj** – Kush është dakord me nenin 10 me sugjerimin e bërë?

Po, zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Kisha një pyetje: pse duhet të jetë dhjetë ditë nga data e ardhjes së aktit për botim, edhe në qoftë se ata e sjellin të përgatitur edhe në version elektronik, edhe në versionin e printuar? Duke pasur parasysh se ç’thotë më pas neni 11, mund ta kuptoj arsyen e këtij afati dhjetëditor, që thotë: “Botohen në të njëjtën kohë”. Megjithatë, nëse i vjen materiali i gatshëm, mos është i gjatë afati dhjetëditor?

**Fatmir Xhafaj** – Deri në dhjetë. Mund ta bëjë edhe për dy orë.

**Oerd Bylykbashi** – Atëherë...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem! Ju lutem! Me mikrofon.

**Miranda Rira** – Mënyra e formulimit të këtij paragrafi, të kësaj dispozite, është se nuk është taksative ditën e dhjetë, por thotë “jo më vonë se dhjetë ditë”.

**Fatmir Xhafaj** – Pra, ka edhe një afat tavan.

**Miranda Rira** – Të jep limitin, që do të thotë se brenda kësaj kohe mund ta botojë në çdo kohë.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull! Dakord! Biem dakord me nenin 10? Kundër? Abstenime s'ka. Miratohet.

Neni 11. Dakord? S'ka as vërejtje, as sugjerime.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Neni 11? Zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Nëse ne në një nen më poshtë themi: “si moment i botimit është futja në arkivin elektronik, ora dhe data e futjes në arkivin elektronik”, a mos kemi konflikt këtu me nenin 11? Nga ana tjetër, nëse ne e quajmë të botuar në momentin kur e kemi futur në arkivin elektronik, akti ka ardhur i përgatitur, është i gjithi i përfunduar, a duhet se s'bën që ne t'i lidhim të dyja bashkë me njëra-tjetrën?

**Fatmir Xhafaj** – Po.

**Oerd Bylykbashi** – E fut në arkiv. Vetë ligji thotë se kur e fut në arkiv elektronik quhet i botuar. Tani, kur e ke gati, ti pret.

Zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Në fakt, ne kemi pasur një debat lidhur me botimin dhe kemi thënë se botimi do të quhet... Kur ka ardhur akti për botim, por nuk është përgatitur akoma, ai mban përgjegjësi, sepse ju thatë se vjen i rregulluar. Jo gjithmonë vjen i rregulluar. Mund të jetë pa “ë”, pa “ç”, mund të ketë probleme. Mos harro se ka marrëveshje të mëdha. Ne kemi thënë se do të votohet ligji, projektligji dhe marrëveshja. Kjo është goxha punë dhe do të ketë një format të caktuar, qoftë për Fletoren Zyrtare, që do ta miratojmë së bashku tani, qoftë edhe për formatin elektronik. Gjithashtu i kemi shtuar një kompetencë qendrës së publikimeve zyrtare, që faqen elektronike ta ketë, ta ngarkojë materialin në mënyrë të tillë që sapo të kërkojmë ne një dokument konkret, ta gjejmë menjëherë, të mos na dalin tridhjetë dokumente, por të dalë dokumenti më i fundit, ai i përditësuar dhe që është në fuqi, pra të mos dalë shtojca. E kjo ka nevojë për punë, edhe për atë korrektorin që do ta rregullojë, edhe për drejtoreshën që do ta miratojë, edhe për atë që do ta hedhë në arkivin elektronik.

**Fatmir Xhafaj** – U sqaruam. Në rregull! Dakord!

Dakord me nenin 11? Kundër? Abstenime s’ka. Miratohet.

Neni 12. “Regjistri shtetëror i akteve.”

**Eduard Halimi** – Kemi nenin 10. Apo e vendosën ata nenin 10...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Te neni 11 kam një pyetje. Këtu, në pikën 1 thuhet se “Fletorja Zyrtare dhe buletini i njoftimeve në formë elektronike publikohen në të njëjtën ditë me atë të shkruarin”.

Çështja që është diskutuar gjatë ka qenë pikërisht kjo: që do t’i botojmë në mënyrë elektronike, në mënyrë që të krijohen sa më shumë efekte. Sepse, për një arsye apo për një tjetër mund të mblidheshin bashkë në formë të shkruar dhe mund të bëhej një botim një herë në muaj, edhe për ekonomi. Çështja kryesore e reformës në QBZ kjo ka qenë, ekonomia, ekonomizimi edhe i burimeve atje.

Tani, ka një ndryshim. Sot vihet me një variant që do të botohen bashkë. Domethënë, nuk ka rëndësi që i hedhim në mënyrë elektronike, por duhet të presim të botohet në Fletoren Zyrtare në formë të shkruar, në mënyrë që të fillojë data, ecuria. Pse bëhet një gjë e tillë? Pse kemi një cedim pas? Sepse ka qenë ndryshe. Besoj se është edhe në vende të tjera. Pra, dita e publikimit në formë elektronike, dita e hyrjes në fuqi të vendimit, të aktit nënligjor apo ligjor.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Fatmir Xhafaj** – Po, ministria?

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** – Te neni 11 thuhet: Momenti i daljes së Fletores Zyrtare nga botimi konsiderohet data dhe ora e përfshirjes në arkivin elektronik të akteve. Pra, kur futet në faqen elektronike.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Arben Isaraj** – Kur ne themi të marrim të njëjtën datë kur del në atë elektroniken, po atë datë do të marrim te Fletorja Zyrtare; kjo nuk do të thotë se Fletorja Zyrtare mund të bëjë edhe dy ditë më mbrapa, por ajo do të shkojë atje ku janë abonentët, kurse të gjithë e kanë mundësinë ta marrin në

mënyrë elektronike. Pra, ka atë datë. Kjo është. Ky është sensi. Nuk ka ndonjë problem që të cedojë, të ketë konflikt.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Eduard Halimi** – Mua si qytetar më intereson dita e hyrjes në fuqi. Çfarë është administrative, çfarë date i vini apo çfarë s’i vini ju Fletores, është çështja juaj. Mua më intereson data e hyrjes në fuqi të aktit, dhe do të jetë data në të cilën është botuar në mënyrë elektronike. Do të jetë dita e botimit në mënyrë elektronike. Kjo gjë duhet thënë te pika 1, besoj unë.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** – Të them diçka? Në fakt, në paragrafin e parë të nenit 11, në Fletoren Zyrtare, si formati i shtypur, ashtu edhe ai elektronik normalisht duhet të dalin brenda një dite. Nuk dalin dot, sepse do kohën e vet. Atëherë, ne nuk do të presim derisa të shtypet e të shkojë tek abonenti. Atëherë themi: “botimi në formën elektronike i Fletores Zyrtare duhet të përmbajë informacione në lidhje me orën e publikimit” dhe ky është momenti i daljes së Fletores Zyrtare. Kjo është data që do të quhet e botuar.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Zoti Halimi, jam dakord! Hajde ta riformulojmë dhe jam shumë dakord!

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Fatmir Xhafaj** – Më falni! Më falni, ju lutem!

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ju lutem, a ka mundësi? Ka vetëm një problem që duhet sqaruar, jo njëqind. Problemi është të jetë e qartë se kur do të quhet hyrja në fuqi. Pikë. Të tjerat janë llafe boshe, pastaj, në daç shtypje, në daç pa shtypje...

Ministria, të lutem, vetëm këtë të thotë dhe këtu të jetë e qartë. Mos ta zgjasim kot.

**Edlira Jorgaqi** – Nëpërmjet propozimeve që ka sjellë Këshilli i Ministrave dhe parashikimit konkretisht të pikës 1 të nenit 11 të projektligjit, është rasti ideal që ne synojmë të arrijmë, që Fletorja

Zyrtare dhe buletini i njoftimeve zyrtare në formë elektronike të publikohen në të njëjtën datë dhe hyrja në fuqi është në të njëjtën kohë për të dyja.

Përrjashtimi është ajo që diskutohet, në qoftë se nuk do të jetë në gjendje në të njëjtën kohë të bëhet edhe publikimi në hard-copy, edhe publikimi në rrugë elektronike...

**Fatmir Xhafaj** – Cila do të jetë, cila do të quhet dita zyrtare?

**Edlira Jorgaqi** – Është në rrugë elektronike dhe është thënë shprehimisht në paragrafin e dytë, ku thuhet: “Momenti i daljes së Fletores Zyrtare nga botimi konsiderohet data dhe ora e përfshirjes në arkivin elektronik të akteve.”

Faleminderit!

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Armando Subashi** – Shiko, a t’ju bëj një koment, se mbase jam i gabuar, por...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Fatmir Xhafaj** – Paraqitja elektronike... Patjetër!

**Armando Subashi** –Unë mendoj që botimi në këtë rast është term juridik dhe publikimi pastaj është diçka tjetër, që ka të bëjë me bërjen të ditur opinionit publik. Në këtë rast, kur flasim për botimin, pika 1 mund të rrijë shumë mirë. Fletorja Zyrtare dhe buletini i njoftimeve zyrtare në formë elektronike botohen, sepse edhe termi kushtetues lidhet me termin “botim” dhe nuk lidhet me termin “publikim”. Botohen në të njëjtën ditë. Pikë. Ky është termi juridik dhe kushtetues dhe këtu fillon pastaj edhe momenti i hyrjes në fuqi, pra nga momenti i botimit. Pastaj, se kur Fletorja Zyrtare shtypet, qepet, shkon atje te abonenti, kjo është histori tjetër, por termi juridik në këtë rast është botimi dhe këto duhet të përputhen.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Eduard Halimi** – Ne po abstragojmë kot. Po e analizove, e quajmë botim. Po ne e kaluam nenin 3. Çfarë botimi në nenin 3? Është botimi i Fletores. Tani, ne a e kaluam? Botimi, këtu thuhet, në formë të shkruar dhe elektronike. Këtu nuk flet as për publikime, as për dalje në televizor.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Po e mbyll diskutimin, se e hapa këtë diskutim dhe dua ta mbyll. Vihet vetëm një fjali ku të thuhet: “Afati për efekt të hyrjes në fuqi është dita e botimit në Fletoren Elektronike.” Kaq.

Është thënë, duhet riformuluar më mirë ajo që është thënë te pika. Dakord?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Dakord me sugjerimin?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Pse je kundër ti?

**Pandeli Majko** – Ja ta them unë. Në nenin 84 të Kushtetutës kemi: “Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare.” Kur kjo pikë është miratuar në nenin e Kushtetutës, nuk ka pasur faqe elektronike.

Kushtetuta, me interpretimin përkatës të asaj kohe e të kësaj kohe, ka nënkuptuar botimin. Jo në faqe elektronike

**Fatmir Xhafaj** – Ka botim elektronik, ka edhe botim shtypi.

**Pandeli Majko** – Por në formatin Fletore Zyrtare, faqe A4.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Tani, që ka zhvillime teknologjia, kjo është e qartë, por ne e dimë se ka virus, ka probleme, ka kompjuter, prandaj, faqja elektronike nuk i sillet si provë gjykatës, por sillet Fletorja Zyrtare.

Tani, me sa di unë, të paktën, mund të ndodhin gjëra të natyrave të ndryshme. Ju lutem, mos e lini elektronikën të shkojë e të marrë kot, se elektronikja mund të na krijojë vetëm probleme e precedentë të natyrave shumë të rrezikshme. Ose e barabartë në një kohë, ose vetëm Fletorja Zyrtare e botuar në format A4, me tel, jo me spango.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** – Edhe një herë, zoti kryetar.

**Fatmir Xhafaj** – Po pra, po. Shiko, mos ta...

**Vasilika Hysi** – Do t’ju lutesha shumë...

**Fatmir Xhafaj** – Shto miell e shto ujë, doli...

**Vasilika Hysi** – Tashti, ne jemi lodhur, kemi që në mëngjes. Do t’ju them vetëm kaq. Ne themi: këtu nuk flitet për botimin e Fletores Zyrtare në formë të shtypur, por ne themi: “Fletorja Zyrtare dhe botimi i njoftimeve zyrtare në formën elektronike, botohen në të njëjtën ditë kur është publikuar edhe në formën e shtypur.” Dhe kur është në formën e shtypur, është neni 84. Ne flasim kur do të futet elektronikisht.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull. Dakord me sugjerimin që u bë, mos ta zgjasim.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Eduard Halimi** – Kur është bërë në mënyrë elektronike, është diskutuar se neni kushtetues nuk e ka pasur, prandaj është hezituuar shumë në hartimin e atij ligji prej vitesh, por sa herë që botohet Fletorja Zyrtare edhe sot, botohen automatikisht 100 kopje, me urdhër të ministrit, që të jenë aty, në arkiv. Kështu që nuk përfshihet as Kushtetuta...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Pandeli Majko** – Mua më krijoi përshtypjen se këtu po diskutohej që ligji mund të hynte në fuqi vetëm me publikimin elektronik. Pastaj, teknikaliteti mund të thoshte pak më vonë do të shtypet me Fletoren Zyrtare e të tjerë e të tjerë. Po krijuam precedent jo të njëjlojshëm...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Të dyja dakord, veçmas. Vetëm Fletorja me interpretimin përkatës të nenit kushtetues.

**Fatmir Xhafaj** – Po, rishikojeni këtë, me sugjerimin që u bë.

Dakord në parim? Dakord?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Dakord neni 11.

Neni 12 “Regjistri shtetëror i akteve”. Pa vërejtje. Miratohet. Dakord. Miratohet.

Neni 13 “Detyrimet për bashkëpunim.

Ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14. “Arkivi elektronik i akteve krijohet pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare. Qendra e Botimeve Zyrtare...” Ka ndryshuar vetëm pika 1.

Dakord?

Zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Faleminderit!

Kemi një bazë të dhënash mjaft të rëndësishme shtetërore, që është baza, e cila do të mbajë të gjitha aktet zyrtare në formën e tyre përfundimtare dhe formën me të cilën ka hyrë në fuqi ligji.

Në fakt, të paktën unë nuk shoh ndonjë referencë se si do të sigurohet integriteti i kësaj baze të dhënash. Sigurisht ka një ligj, por është mirë që të bëjmë referenca të legjislacioni përkatës, në mënyrë që askush të mos ketë mundësi të ndërhyjë në këtë bazë të dhënash, të bëjë modifikime pa respektuar procedurat, protokollet e përcaktuara në legjislacionin që mbron bazat e të dhënave shtetërore.

**Fatmir Xhafaj** – I ke këto të paragrafi i dytë, është baza elektronike e të dhënave që mbledh të gjitha aktet.

**Oerd Bylykbashi** – Aty është se çfarë është kjo, unë them, si mbrohet kjo? Pra, a mundet dikush të hyjë në këtë bazë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po. Në rregull, dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Zonja Jorgaqi, jeni dakord me vërejtjen?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** - Jeni dakord me nenin 14? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 14.

Neni 15. Jeni dakord me sugjerimin e bërë në pikën 6?

Zonja Jorgaqi?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Jeni dakord kolegë?

**Vasilika Hysi** – Neni 15, te pika 6, do të themi: “Aktet e botueshme ngarkohen në arkivin elektronik duke i klasifikuar ato me kujdes sipas llojit të tyre, jo attributeve të aktit, por fushës së veprimit të zbatimit të aktit”. Ta heqim “atributet” për të qenë lehtësisht e kërkueshme.

Në qoftë se doni edhe “atributet e aktit”, hajde ta lëmë. Ideja është që sot ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull, e lëmë. Po të doni të hyni sot në faqen e internetit të Qendrës së Publikimeve, doni të gjeni një ligj, ju dalin 300 lloje ligjesh, më tepër dalin të Kosovës sesa të Shqipërisë. Prandaj duhet rregulluar që të dalë akti që ne kërkojmë.

**Fatmir Xhafaj** – Ajo është çështje e softeve, nuk është çështje e ligjit. Deri dje hapej me gisht, tani...

Zonja Jorgaqi, jeni dakord me këtë siç është këtu?

**Edlira Jorgaqi** – Siç është formulimi? Me atributet e aktit? Po!

**Fatmir Xhafaj** – Jeni dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 15 siç është shkruar këtu me ndryshimin e pikës 6.

Neni 16, “Buxheti”. Dakord?

**Eduard Halimi** – Te “Buxheti” thuhet: “Do të ketë buxhet vetë kjo”. Si do të ketë buxhetin e vet, të ardhurat që do t’i siguroj vetë, do t’i marrë vetë lekët? Siguron nga buxheti i shtetit dhe nga buxheti i saj, thotë. Ç’kuptojmë? Përveç buxhetit të shtetit dhe buxhetit të saj...

(Diskutime pa mikrofon.)

Këtë gjë dhe pyetjen e dytë kam po këtu. Thoni që pas 3 vjetësh do shpërndani Fletoren Zyrtare pas 5 vjetësh. A ishin në abonim ato? Çfarë fletore do të shpërndani ju?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Do të prodhohen të tjera?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** - Urdhëroni!

**Vasilika Hysi** – Në fakt ne kemi diskutuar shumë lidhur me pikën 5 dhe 6, por lidhur me pikën e parë jam dakord me riformulimin që bën zoti Halimi dhe unë propozoj të riformulohet si më poshtë: ...

**Fatmir Xhafaj** – Cila?

**Vasilika Hysi** – Pika 1 e nenit 16. “Qendra e Botimeve Zyrtare financohet nga buxheti i shtetit si zë i veçantë në Ministrinë e Drejtësisë”.

**Fatmir Xhafaj** – Çfarë lidhje ka kjo?

**Vasilika Hysi** – Nuk duhet fjala “buxheti i saj”, i Qendrës, sepse është dy herë fjala “buxheti”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Fatmir Xhafaj** – Jo, nuk ka tjetër pyetje ai, nuk ka këtë që thua ti fare. Nuk ka lidhje fare.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Si është kjo, zonja Jorgaqi?

**Edlira Jorgaqi** – Si ka funksionuar deri tani, do të vazhdojë të funksionojë. Ky lloj parashikimi ka qenë edhe më përpara në ligjin ekzistues, nuk ka asnjë ndryshim.

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Arben Isaraj** – Mendoj të mos u kthehem prapë gjërave të mëparshme. Në qoftë se në fillim i dhamë ministrit të Drejtësisë të drejtën që, mbas studimeve që do të bënte bashkë me zyrën e Botimeve Zyrtare, të identifikonte se kujt duhet t’i shkonte falas apo në bazë të abonimeve dhe

kërkesave, nuk e kuptoj këtë. Në qoftë se kanë ngelur 2 apo tre fletore jashtë këtyre parashikimeve, që nuk i kanë tërhequr institucionet , mund t'u dhurohen falas këtyre qendrave, të cilat mbrojnë shtresat në nevojë dhe nuk ka mundësi për t'i tërhequr në mënyrë tjetër këto.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Jeni dakord me nenin 16? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Jeni dakord me nenin 17? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po pra, me dy shtesat.

Zonja Jorgaqi, jeni dakord me nenin 17, me dy shtesat që keni bërë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Ankesat dhe auditi ligjor.

Jeni dakord, zonja Jorgaqi?

**Edlira Jorgaqi** – Dakord.

**Fatmir Xhafaj** – Miratohet neni 17.

Neni 18, “Aktet nënligjore”.

Jeni dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19, “Shfuqizime”.

Jeni dakord?

Neni 20, “Hyrja në fuqi”

Jeni dakord? Dakord.

Jeni dakord në tërësi?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Një minutë, ju lutem, para se ta votojmë në tërësi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jeni dakord me këtë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord edhe me këtë.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Nesër është mbledhja e komisionit sipas kalendarit. Sipas propozimit, nesër është projektligji “Për përdorimin e armëve të zjarrit”, projektligji “Për armët”, projektligji “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe kaq. Nesër në orën 9:00.

Faleminderit!

Edhe KQZ-ja është për nesër.

E mbyllim këtu.

Faleminderit!

Faleminderit, zoti Isaraj! Faleminderit, zonja Jorgaqi! Faleminderit, kolegë deputetë!

Natën e mirë!



